



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

Raporti vjetor i punës për vitin 2020

drejtuar

Kuvendit të Republikës së Kosovës

Mars 2021

Faqe 1 nga 51

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	7
KORNIZA LIGJORE	8
PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT.....	8
<i>Misioni i KPM-së është:</i>	<i>8</i>
ORGANIZIMI INSTITUCIONAL	8
<i>Përbërja dhe mandati i anëtarëve të KPM-së.....</i>	<i>8</i>
<i>Përbërja e KPM-së gjatë vitit 2020</i>	<i>9</i>
<i>Nominimet dhe emërimet e anëtarëve të KPM-së gjatë vitit 2020.....</i>	<i>10</i>
AKTIVITETET E KPM-së.....	10
<i>Mbledhjen e parë për vitin 2020 KPM e ka mbajtur më 31 janar 2020</i>	<i>11</i>
<i>KPM ka mbajtur mbledhjen e dytë me radhë më 28 shkurt 2020</i>	<i>12</i>
<i>KPM ka mbajtur mbledhjen e tretë më 22 tetor 2020</i>	<i>13</i>
<i>KPM ka mbajtur mbledhjen e katërt më 30 tetor 2020</i>	<i>13</i>
<i>KPM ka mbajtur mbledhjen e pestë më 13 nëntor 2020</i>	<i>14</i>
<i>KPM ka mbajtur mbledhjen e gjashtë më 15 dhjetor 2020.....</i>	<i>16</i>
VAZHDIMI I PUNËS NË HARTIMIN DHE AMANDAMENTIMIN E AKTEVE NËNLIGJORE	17
<i>Konsultimet publike lidhur me aktet nënligjore të KPM-së</i>	<i>17</i>
<i>Miratimi i Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele</i>	<i>17</i>
RAPORTIMI I KPM-së NË TAKIMET E DIALOGUT TË PROCESIT TË STABILIZIM ASOCIIMIT	18
PUBLIKIMET LIDHUR ME PAJTUESHMËRINË E OSHMA-VE ME AKTET NËNLIGJORE	19
<i>Publikimi i Raportit të Monitorimit “Mbrojtja e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuale”</i>	<i>19</i>
BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE	20
<i>Bashkëpunimi në kuadër të Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullatore (EPRA).....</i>	<i>20</i>
<i>Konferenca regjionale e autoriteteve rregullative të mediave, në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022 – Faza II”</i>	<i>20</i>
<i>Vazhdimi i bashkëpunimit në mes të KPM-së dhe AMA-së.....</i>	<i>20</i>
<i>Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit në mes të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Departamentit të Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës.....</i>	<i>21</i>

<i>Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit për Procesin Zgjedhor</i>	22
ANGAZHIMET E KPM-së GJATË PANDEMISË COVID-19	22
<i>Shtyrja e afatit për raportim vjetor për të licencuarit</i>	22
<i>Angazhimi i Komisionit të Pavarur të Mediave sa i përket raportimit të mediave në mënyrë profesionale lidhur me Covid-19</i>	22
<i>Bashkëpunimi me Misionin e OSBE-së në Kosovë</i>	23
<i>Organizmi i tryezës konsultative me mediat e licencuara lidhur me hartimin e Draft Rregullores për Pronësinë dhe Koncentrimin e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale</i>	23
<i>Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Institutit të Medias të Kosovës</i>	24
<i>Angazhimi i KPM-së në monitorimin e të licencuarve gjatë fushatës zgjedhore në zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut</i>	24
<i>Angazhimi i Komisionit të Pavarur të Mediave në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës ndaj Grave</i>	25
PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE	25
<i>Burimet njerëzore</i>	26
DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZËS (DMA)	26
<i>Pajtueshmëria me Rregulloren KPM 2017/07 për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuale</i> ..	26
<i>Pajtueshmëria me të Drejtën e Autorit</i>	27
<i>Pajtueshmëria me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Distributimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë</i>	27
<i>Monitorimi i lajmeve qendrore të OSHMA-ve</i>	28
<i>Zgjedhjet për kryetar të komunave</i>	29
<i>Zgjedhjet për kryetar të Komunës së Podujevës, mars 2020</i>	29
<i>Zgjedhjet për kryetar të Komunës së Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut, nëntor 2020</i>	29
<i>Vizitat në terren</i>	30
DEPARTAMENTI I LICENCIMIT	31
<i>Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës</i>	31
<i>Numri i TV dhe Radio stacioneve të licencuara sipas gjuhëve</i>	31
<i>Numri i Operatorëve të Shpërndarjes (OSH) të licencuar</i> :	31
<i>Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (OSHMA) të cilët transmetojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes</i>	31
<i>Shqyrtimi i kërkesave</i>	32

<i>Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2021, ato të bartura tek Departamenti Ligjor dhe rastet e mbyllura pa nevojë për vendim të Komisionit:</i>	<i>32</i>
DEPARTAMENTI LIGJOR	33
<i>Rastet për transmetim ilegal - Shkelja e nenit 21, paragrafi 1, dhe nenit 30, paragrafi 5, të Ligjit 04/L-44 për KPM-në.....</i>	<i>33</i>
<i>Rastet e Shkeljes së Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, nenit 28 - Mos sjellja e Raportit vjetor..</i>	<i>33</i>
<i>Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM -2017/07.</i>	<i>33</i>
<i>Rastet për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale KPM- 2013/01</i>	<i>34</i>
<i>Rastet e shkeljes së Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03</i>	<i>34</i>
<i>Rastet për shkeljen e Rregullores për Tarifën Vjetore për Licencë KPM-2017/06 - Mos pagesa e taksës për licencë dhe gjokat e shqiptuar nga Komisioni i KPM-së.....</i>	<i>34</i>
<i>Rastet për shkeljen Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01 dhe Rregulloren KPM-2020/01 e cila ka hyr në fuqi me datën 3 nëntor 2020</i>	<i>34</i>
<i>Rastet dhe Kërkesat tjera të proceduara nga KPM-ja gjatë vitit 2020, rastet e shkeljes së Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03</i>	<i>35</i>
DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR.....	40
<i>Analiza e Spektrit Frekuencor –Transmetimet analoge.....</i>	<i>40</i>
<i>Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21).....</i>	<i>41</i>
<i>Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini).....</i>	<i>42</i>
<i>Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regjional dhe lokal.....</i>	<i>42</i>
<i>Rastet për interferencë</i>	<i>42</i>
<i>Rastet për transmetime të pa licencuara.....</i>	<i>43</i>
<i>Frekuencat e revokuara nga KPM.....</i>	<i>43</i>
<i>Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me KFOR.....</i>	<i>43</i>
<i>Kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit.....</i>	<i>43</i>
<i>Raste të ndryshimit të lokacionit të transmetuesit pa miratim të KPM-së.....</i>	<i>43</i>
<i>Gjendja për prezencën e sinjaleve televizive tokësore dixhitale, gjegjësisht evidentimi i prezencës së sinjaleve nga shtetet fqinjë.....</i>	<i>44</i>
<i>Rekomandime</i>	<i>44</i>
DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE.....	45
<i>Buxheti.....</i>	<i>45</i>
<i>Realizimi i të hyrave.....</i>	<i>46</i>

<i>Të arkëtueshmet nga tarifa për licencë.....</i>	<i>47</i>
PUNA E BORDIT PËR ANKESA	48
<i>Përbërja aktuale e Bordit për Ankesa</i>	<i>48</i>
<i>Përbërja e Bordit gjatë vitit 2020</i>	<i>48</i>
<i>Seancat dhe Vendimet e Bordit për Ankesa</i>	<i>48</i>
OBJEKTIVAT E PËRCAKTUARA PËR VITIN 2020	49
1. <i>Avancimi i kornizës ligjore.....</i>	<i>49</i>
2. <i>Promovimi i Edukimit Medial “Media Literacy”</i>	<i>49</i>
3. <i>Dixhitalizimi i shërbimeve të KPM-së (e-KPM)</i>	<i>49</i>
4. <i>Implementimi i dixhitalizimit në nivel shtetëror.....</i>	<i>49</i>
OBJEKTIVAT E VITIT 2021	49
1. <i>Avancimi i kornizës ligjore.....</i>	<i>49</i>
2. <i>Promovimi i Edukimit Medial “Media Literacy”</i>	<i>50</i>
3. <i>Dixhitalizimi i shërbimeve të KPM-së (e-KPM)</i>	<i>50</i>
4. <i>Implementimi i dixhitalizimit në nivel shtetëror.....</i>	<i>50</i>
5. <i>Zgjerimi i rrjetit të bashkëpunimit me organizatat vendore dhe ndërkombëtare</i>	<i>50</i>
REKOMANDIMET/SFIDAT E INSTITUCIONIT	50
<i>Vështirësitë dhe sfidat lidhur me pavarësinë financiare</i>	<i>50</i>
<i>Nevoja për rritjen e numrit të stafit.....</i>	<i>50</i>
AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31	
DHJETOR 2019	51
<i>Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)</i>	<i>51</i>

SHTOJCAT

Shtojca I - Organogrami

Shtojca II - Tabela e Rasteve Ligjore

Shtojca IIIa - Raporti Vjetor Financiar

Shtojca IIIb - Raporti Vjetor Financiar

Shtojca IV - Raporti i Monitorimit “Mbrotjtja e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuele”

Shtojca V - Raporti i Monitorimit “Monitorimi i lajmeve qendrore të OSHMA-ve”

Shtojca VI - “OSHMA-të gjatë fushatës për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut 2020”

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport paraqet aktivitetet e Komisionit të Pavarur të Mediave (në vazhdim KPM), për periudhën kohore janar-dhjetor 2020, të cilin ju përcjellim në pajtim me nenin 3, paragrafi 2, pika 8, të Ligjit Nr. 04/L44 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Ashtu siç kërkohet nga Kuvendi, raporti është i ndarë në kapituj ku është bërë prezantimi i mandatit, kompetencave dhe përgjegjësisë të KPM-së. Për shkak të shpalljes së gjendjes emergjente në shëndetin publik nga Ministria e Shëndetësisë në kuadër të masave mbrojtëse kundër COVID 19, KPM-ja nuk ka arritur të zhvillojë shumë prej aktiviteteve të planifikuara.

Raporti i punës së KPM-së për vitin 2020, përmban të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë periudhës kohore për të cilën raportohet, amandamentimi dhe miratimi i akteve nënligjore, bashkëpunimi i KPM-së me të licencuarit, bashkëpunimi me organizatat vendore e ndërkombëtare që veprojnë në Republikën e Kosovës dhe bashkëpunimi me rregullatorët në rajon e më gjerë. Po ashtu, në raport është dhënë një përmbledhje e pasqyrës së pajtueshmërisë së ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele, me Ligjin dhe të gjitha aktet nënligjore të KPM-së, të dhënat rreth numrit të të licencuarve, rastet ligjore të proceduara, shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Republikës së Kosovës – licencime të reja për radio transmetim, raporti financiar si dhe veprimet e ndërmarra për gjetjet dhe rekomandimet e Zyrës Kombëtare të Auditimit për vitin paraprak.

Në mungesë të mbështetjes financiare apo çfarëdo forme tjetër nga Qeveria e Kosovës, edhe për vitin 2021 prioritet i KPM-së mbetet implementimi i procesit të dixhitalizimit sipas Ligjit Nr. 04/L44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Ligjit Nr.05/L-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radio Difuze Tokësore, zhvillimi i pluralizmit medial që u shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Në këtë aspekt, miratimi i strategjisë për dixhitalizim nga Qeveria e Kosovës vazhdon të mbetet prioritet i lartë për zgjidhjen e procesit të dixhitalizimit në vend.

Gjithashtu, harmonizimi i akteve nënligjore dhe hartimi i akteve të reja nënligjore që rrjedhin si obligim nga procesi i dixhitalizimit, në harmoni me rregullativën evropiane si dhe zhvillimi i politikës së transmetimit mbeten prioritet i KPM-së për vitin 2021.

Mars 2021

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

Faqe 7 nga 51

KORNIZA LIGJORE

KPM-ja është organ kushtetues i përcaktuar me nenin 141 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Është themeluar me Ligjin Nr. 04/L-44 për KPM-në, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 2 mars 2012 dhe i cili ka hyrë në fuqi më 20 prill 2012.

Me nenin 3, paragrafin 2.8, të Ligjit për KPM-në përcaktohet që: *“KPM-ja i paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës, deri me 31 mars të vitit vijues një raport vjetor, duke përfshirë edhe të dhënat e plota në lidhje me përcaktimin dhe zbatimin e politikës së transmetimit, dhënien e licencave dhe të ankesave, sanksionet që zbatohen dhe vendimet në lidhje me to, aktivitetet financiare, aktivitetet e tjera të transmetimit si dhe objektivat për vitin e ardhshëm. Raporti vjetor duhet të bëhet publik pas miratimit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës”.*

PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

KPM-ja është organ i pavarur, kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit. KPM-ja rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audio-vizuele.

Misioni i KPM-së është:

- Të nxisë dhe të mbajë një sistem të drejtë dhe të hapur për licencimin dhe rregullimin e shërbimeve mediale audio-vizuele dhe për menaxhimin e spektrit të frekuencave të transmetimit në pajtim me standardet më të mira ndërkombëtare;
- Të kontribuojë në profesionalizimin e shërbimeve mediale audio-vizuele;
- Të mbështes lirinë dhe pluralizmin e shërbimeve mediale audio-vizuele.

ORGANIZIMI INSTITUCIONAL

Përbërja dhe mandati i anëtarëve të KPM-së

Sipas Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, KPM-ja përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, të cilët duhet të jenë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: kultura, arti, drejtësia, kinematografia, gazetaria, biznesi, menaxhmenti, marrëdhënie me publikun, marrëdhënie ndërkombëtare, media dhe teknologjia informative.

Procedura për emërimin e anëtarëve të KPM-së bëhet sipas nenit 11, pika 2.1, të Ligjit për KPM-në, i cili përcakton se: *“brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të*

KPM-së apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, KPM nxjerr shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj”.

Përbërja e KPM-së gjatë vitit 2020

Emri	Mbiemri	Pozita	i/e emëruar	Kohëzgjatja e mandatit
Xhevat	LATIFI	Kryetar	16 tetor 2020	mandat dy (2) vjeçar
Granit	MUSLIU	Nënkryetar	16 tetor 2020	mandat dy (2) vjeçar
Azra	DEŠIĆ	Anëtare	16 tetor 2020	mandat tre (3) vjeçar
Violeta	HYSENI KELMENDI	Anëtare ¹	më 17 prill 2018	mandat katër (4) vjeçar
Maja	SLAVIĆ	Anëtare	më 17 prill 2018	mandat tre (3) vjeçar
Muja	FERATI	ish - Kryetar ²	më 30 maj 2018 deri më 30 maj 2020	mandat dy (2) vjeçar
Anita	MURIQI	ish - Anëtare	më 30 maj 2018 deri më 30 maj 2020	mandat dy (2) vjeçar
Vlorë	BERISHA	ish - Anëtare	30 nëntor 2017 deri më 30 nëntor 2020	mandat tre (3) vjeçar

¹ znj. Violeta HYSENI KELMENDI është zgjedhur Nënkryetare e KPM-së në mbledhjen e KPM-së të mbajtur më 21 qershor 2018 dhe ka përfunduar mandatin si Nënkryetare e KPM-së me 21 qershor 2020.

² z. Muja FERATI është zgjedhur Kryetar i KPM-së në mbledhjen e KPM-së të mbajtur më 21 qershor 2018 dhe ka përfunduar mandatin me 30 maj 2020.

Xhemajl	KRASNIQI	ish - Anëtar	17 nëntor 2016 deri më 17 nëntor 2020	mandat katër (4) vjeçar
----------------	----------	--------------	---	-------------------------

Mandati i anëtarëve të KPM-së përcaktohet me short në bazë të nenit 13, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Nominimet dhe emërimet e anëtarëve të KPM-së gjatë vitit 2020

Gjatë periudhës raportuese, Zyra Ekzekutive e KPM-së ka kryer të gjitha procedurat e nominimeve ashtu siç është e përcaktuar me Ligjin për KPM-në. Bazuar në Nenin 11, pika 2.1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, dhe Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.06-V-321, datë 28.02.2019, KPM me 18 shkurt 2020 ka bërë ftesë tjetër publike për nominime për një anëtarë të KPM-së, nga komuniteti jo shumicë. Afati ka qenë 15 ditë pune, prej: 18 shkurt 2020 deri me 3 mars 2020. Të gjitha nominimet e pranuar janë përcjell sipas procedurës në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Bazuar në Nenin 11, pika 2.1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, është shpallur ftesa publike për nominime për dy (2) anëtarë të KPM-së nga radhët e komunitetit shqiptar. Afati ka qenë 15 ditë pune prej: 1 prill 2020 deri me 15 prill 2020. Të gjitha nominimet e pranuar janë përcjell sipas procedurës në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), bazuar në nenin 11 të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, me 18 shtator 2020 ka shpallur ftesën publike për nominime për dy (2) anëtarë të KPM-së nga radhët e komunitetit shqiptar. Afati ka qenë i hapur për 15 ditë pune prej 18 shtator 2020 deri më 2 tetor 2020. Të gjitha nominimet e pranuar në këtë proces janë përcjell sipas procedurës në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën e mbajtur me 16 tetor 2020, ka emëruar tre anëtarë të KPM-së: Xhevat Latifi – mandat 2 vjeçar, Granit Musliu – mandat 2 vjeçar dhe Azra Dešić – mandat 3 vjeçar.

Në mbledhjen e mbajtur me 22 tetor 2020 të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), anëtarët e Komisionit kanë votuar për zgjedhjen e Kryetarit dhe Nënkyetarit të Komisionit të KPM-së. Pas procesit të votimit, Kryetar i Komisionit të KPM-së është zgjedh z. Xhevat Latifi, ndërsa Nënkyetar është zgjedh z. Granit Musliu.

AKTIVITETET E KPM-së

Në kuadër të aktivitetit institucional dhe në bazë të obligimeve ligjore, gjatë vitit 2020, KPM-ja ka mbajtur gjashtë (6) mbledhje të rregullta, në të cilat ka shqyrtuar dhe ka marrë vendime për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për KPM-në. Duhet përmendur që në fillim se gjatë periudhës raportuese, për shkak të shpalljes së gjendjes emergjente për shëndetin publik nga Ministria e Shëndetësisë, në kuadër të masave mbrojtëse kundër COVID 19 dhe pastaj për shkak të përfundimit të mandatit të dy prej anëtarëve të KPM-së me 30 maj 2020, e të cilët nuk janë

zgjedhur nga Kuvendi i Republikës së Kosovës deri më 16 tetor 2020, dhe në mungesë të kuorumit për vendimmarrje KPM-ja nuk ka arritur të mbajë mbledhje të rregullta prej muajit mars e deri në tetor dhe as të zhvillojë shumë prej aktiviteteve të planifikuara.

Në vazhdim paraqiten në mënyrë kronologjike dhe të përmbledhur rastet e trajtuara dhe vendimet e marra nga Komisioni gjatë seancave të mbledhjeve të rregullta të vitit 2020.

Mbledhjen e parë për vitin 2020 KPM e ka mbajtur më 31 janar 2020

Në këtë mbledhje Komisioni i KPM-së ka trajtuar disa kërkesa në rastet e licencimit. Këto kërkesa kishin të bënin me rekomandime për ndërprerje të licencës së tre (3) operatorëve të shpërndarjes dhe një (1) ofruesi të shërbimeve mediale audiovizuale. Komisioni ka shqyrtuar rastet e licencimit të renditura në vijim:

- Orange Net – Vendim për ndërprerjen e licencës së operatorit të shpërndarjes (heqje dorë vullnetare nga licenca);
- NTP Ardi - Vendim për ndërprerjen e licencës së operatorit të shpërndarjes (heqje dorë vullnetare nga licenca);
- Mediakos Communications (ish Elektra) - Vendim për ndërprerjen e licencës së operatorit të shpërndarjes (heqje dorë vullnetare nga licenca); dhe
- Star TV - Vendim për ndërprerjen e licencës së ofruesit të shërbimeve mediale audiovizuale (heqje dorë vullnetare nga licenca).

Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive për rastet e licencimit, Komisioni konstatoi se të gjitha rastet i kanë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe ka miratuar të gjitha rekomandimet.

Komisioni ka shqyrtuar edhe Raportin Tremujor tetor – dhjetor 2019 për punën e KPM-së. Pas shqyrtimit, Komisioni ka miratuar raportin për t’u përcjell në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sipas procedurës duke u bazuar në obligimin ligjor që del nga neni 15 i Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

Komisioni ka shqyrtuar gjithashtu edhe “Raportin e monitorimit për zbatimin e Rregullores së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuale”. Pas shqyrtimit Komisioni ka miratuar raportin për tu publikuar.

Po ashtu, në këtë mbledhje Komisioni ka shqyrtuar çështjen e amandamentimit të akteve nënligjore të KPM-së. Pas diskutimit, Komisioni duke u bazuar në nenin 8, paragrafi 2, të Ligjit për KPM-në Nr. 04/L-44, vendosi vënien në diskutim publik të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale. Periudha e diskutimit publik ishte caktuar prej datës 3 shkurt deri me 18 mars 2020.

KPM ka mbajtur mbledhjen e dytë me radhë më 28 shkurt 2020

Në këtë mbledhje, Komisioni i KPM-së ka shqyrtuar disa raste të licencimit, respektivisht kërkesa për licencimin e operatorit të shpërndarjes në platformë satelitore dhe operatorit të shpërndarjes në platformë kabllore:

- TDS SHPK - Vendim për licencimin e operatorit të shpërndarjes (OSH) në platformë satelitore; dhe
- TelKos - Vendim për licencimin e operatorit të shpërndarjes (OSH) në platformë kabllore.

Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive për rastet e licencimit, Komisioni ka gjetë se kërkesat i kanë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe i ka miratuar ato.

Në lidhje me shkeljet e evidentuara nga monitorimi i Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA) gjatë fushatës për zgjedhjet e parakohshme 2019, KPM-ja ka iniciuar disa raste ligjore të cilat kishin të bëjnë me shkelje të legjislacionit të Komisionit të Pavarur të Mediave, respektivisht nenit 49, paragrafi 7, të Kreut VIII-të të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073, për zbatimin e të cilit është përgjegjës KPM-ja. Komisioni ka shqyrtuar rastet e mëposhtme, lidhur me mediat që nuk i kanë dorëzuar në KPM ditarët e zgjedhjeve, sipas obligimit ligjor:

Fwf City Radio; TV Dukagjini; Radio 7; Radio Bambus; Click Channel; Rrokum TV; Tribuna Channel; Zëri TV; Radio Gora; Radio Helix; Radio Omega 3; Radio Romano Avazo; Spin TV; TE7 dhe TV Dielli.

Pas shqyrtimit të rasteve, Komisioni ka gjetur se të gjithë këto OSHMA kanë kryer shkelje të nenit 49, paragrafi 7, të Kreut VIII-të të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-073 dhe ka vendosur masën sanksionuese Vërejtje.

Lidhur me shkeljen e Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuale, Komisioni ka shqyrtuar këto raste: Rrokum TV; TV Opinion; TV Vali; RTK 2; TV Prizreni dhe TV Puls.

Pas shqyrtimit të rasteve, Komisioni ka gjetur se të gjithë këto OSHMA kanë kryer shkelje të nenit 3, paragrafi 1 dhe 3, të Rregullores KPM-2013/01, prandaj ka sanksionuar ato me masën Vërejtje. Gjithashtu, të gjitha OSHMA-të e lartcekura janë obliguar që të nxjerrin Kodin Praktik në të cilin do të përcaktojnë standardet vetërregulluese për transmetimin e programeve që mund të kenë ndikim të dëmshëm tek fëmijët dhe të miturit, dhe këtë Kod të miratuar ta sjellin në KPM brenda tridhjetë (30) ditësh.

Ndërsa, për shkeljen e Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale, Komisioni ka shqyrtuar dy raste:

- J@B NET (OSH) - Pas shqyrtimit të rastit, Komisioni gjeti se ky operator i shpërndarjes ka kryer shkelje të nenit 4, paragrafi 1, nenit 12, paragrafi 2, si dhe nenit 19, paragrafi 2, të Rregullores KPM-2016/01. Komisioni vendosi masën sanksionuese gjobë në shumë prej dymijë (2.000) euro si dhe ka urdhëruar operatorin e shpërndarjes të ndërpres menjëherë transmetimin e ndeshjeve futbolistike të Premier Ligës Angleze.

- COMNET-A (OSH) - Pas shqyrtimit të rastit, Komisioni gjeti se ky operator i shpërndarjes ka kryer shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01. Komisioni vendosi masën sanksionuese gjobë në shumë prej dymijë (2.000) euro si dhe ka urdhëruar operatorin e shpërndarjes COMNET-A, të ndërpresë menjëherë ritransmetimin e kanaleve të platformës së operatorit Kujtesa Net.

Ndërsa me 23 mars 2020, Komisioni ka shqyrtuar Raportin Vjetor për periudhën kohore 1 janar - 31 dhjetor 2019 për punën e KPM-së. Pas shqyrtimit, Komisioni ka miratuar raportin për t'u përcjell në Kuvendin e Republikës së Kosovës, sipas procedurës duke u bazuar në obligimin ligjor që del nga neni 3, paragrafi 2.8, i Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në.

KPM ka mbajtur mbledhjen e tretë më 22 tetor 2020

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 22 tetor 2020 ka zhvilluar mbledhjen e tretë, në përbërje të re dhe të plotë, pas zgjedhjes së tre anëtarëve të rinj nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në këtë mbledhje, anëtarët e Komisionit kanë votuar për zgjedhjen e Kryetarit dhe Nënkyetarit të Komisionit të KPM-së.

Pas procesit të votimit, Kryetar i Komisionit të KPM-së është zgjedhur z. Xhevat Latifi, ndërsa Nënkyetar është zgjedhur z. Granit Musliu. Mandatet e tyre janë dyvjeçare, sipas Ligjit për KPM-në.

KPM ka mbajtur mbledhjen e katërt më 30 tetor 2020

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 30 tetor 2020, ka mbajtur mbledhjen e katërt të rregullt për vitin 2020. Në këtë mbledhje, Komisioni i KPM-së ka trajtuar disa raste ligjore që kishin të bënin me shkelje të legjislacionit të KPM-së respektivisht shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audiovizuale dhe Rregullores KPM-2016/01 për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale. Komisioni i KPM-së ka shqyrtuar rastet ligjore në vijim:

- KTV – Ankesë nga z. Faton Thaçi – pas shqyrtimit të këtij rasti, Komisioni erdhi në përfundim se KTV ka dështuar të marr hapat e nevojshëm për të vepruar në pajtueshmëri me nenin 10, paragrafi 2, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03. Komisioni ka vendosur që KTV të sanksionohet me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit për KPM-në.
- RTK1 – Ankesë nga Devolli Group – pas shqyrtimit të këtij rasti, Komisioni erdhi në përfundim se RTK 1 ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03. Komisioni ka vendosur që RTK 1 të sanksionohet me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit për KPM-në.

- Kumanova Cable OSH – pas shqyrtimit të këtij rasti, Komisioni erdhi në përfundim se Kumanova Cable ka dështuar të marr hapat e nevojshme për të vepruar në pajtueshmëri me nenin 4, paragrafi 1, dhe nenin 12, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01. Komisioni ka vendosur që Kumanova Cable të sanksionohet me gjobë në shumë prej dymijë (2,000) euro në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3, për shkelje të nenit 4, paragrafi 1, nenit 12, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2016/01.

Në këtë mbledhje Komisioni i KPM-së ka trajtuar disa raste të licencimit. Këto raste/kërkesa kishin të bënin me rekomandime për licencimin e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuele (OSHMA) me transmetim përmes operatorit të shpërndarjes (OSH), rekomandime për licencim të operatorit të shpërndarjes si dhe një kërkesë për ndryshim të pronësisë dhe një për ndryshimin e lokacionit të transmetuesit. Rastet e shqyrtuara të licencimit janë të renditura në vijim:

- Rahoveci Channel – Vendim për licencimin e OSHMA-së me transmetim përmes OSH-ve;
- Drini TV – Vendim për licencimin e OSHMA-së me transmetim përmes OSH-ve;
- Artsport 4 – Vendim për licencimin e OSHMA-së me transmetim përmes OSH-ve;
- Artsport 5 – Vendim për licencimin e OSHMA-së me transmetim përmes OSH-ve;
- Artsport 6 – Vendim për licencimin e OSHMA-së me transmetim përmes OSH-ve;
- Advan Tech SHPK – Vendim për licencimin e OSH-së;
- TV Most – Vendim për ndryshim të pronësisë;
- Radio 7 – Vendim për ndryshim të lokacionit të transmetuesit;
- 1 TV – Vendim për licencimin e OSHMA-së me transmetim përmes OSH-ve;
- TGTV – Vendim për licencimin e OSHMA-së me transmetim përmes OSH-ve.

Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive për secilin prej rasteve të licencimit, Komisioni ka konstatuar se të gjitha aplikacionet i kishin plotësuar kriteret ligjore të KPM-së. Prandaj, Komisioni vendosi të miratojë të gjitha kërkesat për licencë të OSHMA-ve përmes OSH-ve, për licencë të OSH-së si dhe kërkesat për ndryshim të lokacionit të transmetuesit dhe ndryshim të pronësisë.

Në këtë mbledhje, Komisioni ka shqyrtuar draftin final të Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele. Pas përfundimit të të gjitha procedurave për nxjerrjen e legjislacionit sekondar ashtu siç përcaktohet me nenin 8 të Ligjit për KPM-në dhe pas shqyrtimit të draftit, Komisioni ka miratuar Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele.

KPM ka mbajtur mbledhjen e pestë më 13 nëntor 2020

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 13 nëntor 2020, ka mbajtur mbledhjen e pestë të rregullt. Komisioni ka shqyrtuar disa raste ligjore që kishin të bëjnë me shkelje të legjislacionit të KPM-së, respektivisht shkelje të nenit 28, paragrafi 2, të Ligjit për KPM-në. Raportimi vjetor është obligim ligjor për të licencuarit, i përcaktuar me Ligjin Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, respektivisht nenin 28, paragrafi 1, i cili përcakton se:

“Shërbimet e licencuara mediale audiovizuele duhet t’i paraqesin raport vjetor KPM-së, në të cilin përfshihet informacioni përkitazi me programin dhe veprimin në përputhje me kushtet e licencës së bashku me një raport financiar të detajuar dhe informacione të tjera të parapara me ligj”.

Ndërsa, neni 28, paragrafi 2, i Ligjit për KPM-në përcakton se:

“Raportet vjetore duhet të dorëzohen në KPM-së jo më larg se me datë 31 mars të vitit vijues, për vitin paraparak. KPM-ja mund të kërkojë informacion të mëtejshëm nëse konsideron se informacioni i paraqitur në raportet vjetor nuk është i plotë.”

Pas shqyrtimit të rasteve, Komisioni ka konstatuar se të licencuarit në vijim: Connect 3, Astra Net, Eagle, Radio Klokot, Radio Urban FM – Prizren, Vision TV, IPTV Tech LLC dhe Radio Capital FM, kanë bërë shkelje të nenit 28, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit për KPM-në, respektivisht kanë dështuar të sjellin raport vjetor sipas obligimit ligjor. Prandaj Komisioni ka vendosur që subjektet e lartpërmendura të sanksionohen me masën Vërejtje dhe që në afat prej dhjetë (10) ditësh ta dorëzojnë raportin vjetor për vitin 2019, ashtu siç përcaktohet me nenin 28, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit për KPM-në.

Ndërsa, për të licencuarit në vijim: Radio Borzani, Radio Energji, Radio Kaçaniku, Radio Shqip FM, Radio Urban FM-Prishtinë, Radio Antena, Kent FM-Prishtinë, Radio Helix, Radio Kent FM 2 – Mamushë dhe Tribuna Channel, pas shqyrtimit Komisioni ka konstatuar se këto subjekte në mënyrë të vazhdueshme kanë bërë shkelje të nenit 28, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit për KPM-së, prandaj Komisioni vendosi që subjektet e lartpërmendura të sanksionohen me masën gjobë dhe që në afat prej dhjetë (10) ditësh ta dorëzojnë raportin vjetor për vitin 2019, ashtu siç përcaktohet me nenin 28, paragrafi 1 dhe 2, të Ligjit për KPM-në.

Gjithashtu, në mbledhjen e pestë Komisioni ka trajtuar edhe disa kërkesa në rastet e licencimit. Këto kërkesa kishin të bënin me rekomandime për ripërtëritje të licencës së operatorit të shpërndarjes (OSH), për ripërtëritje të licencës së ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuele (OSHMA), kërkesë për ndryshim të emrit dhe pronësisë si dhe rekomandime për ndërprerjen e vendimeve të licencimit për OSHMA.

Rastet e shqyrtuara të licencimit janë të renditura në vijim:

- Kumanova Cable SHPK (OSH) – Vendim për ripërtëritje të licencës;
- Speed TV (OSH) – Vendim për ripërtëritje të licencës;
- Link Produkcija (OSH) – Vendim për ripërtëritje të licencës;
- ART – Vendim për ripërtëritje të licencës;
- Dasma TV – Vendim për ripërtëritje të licencës;
- Radio Kalabria – Vendim për ndryshim të pronësisë dhe të emrit; dhe
- Albatrade Music and Movie LLC – ndërprerje e vendimeve të licencimit për OSHMA-të.

Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive për secilin prej rasteve të licencimit, Komisioni ka konstatuar se të gjitha kërkesat i kanë plotësuar kriteret ligjore të KPM-së dhe ka vendosur të miratojë të gjitha rekomandimet e lartcekura.

KPM ka mbajtur mbledhjen e gjashtë më 15 dhjetor 2020

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 15 dhjetor 2020, ka mbajtur mbledhjen e gjashtë të rregullt. Komisioni ka shqyrtuar Raportin gjashtëmuor të punës së KPM-së. Pas shqyrtimit, Komisioni ka miratuar Raportin gjashtëmuor, i cili bazuar në obligimin ligjor që del nga neni 15 i Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, përcillet në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Komisioni ka trajtuar disa kërkesa në rastet e licencimit. Rastet e shqyrtuara kishin të bënin me kërkesa për licencimin e operatorit të shpërndarjes - platformë OTT, kërkesë për ndryshim të emrit dhe skemës programore, kërkesë për ndryshim të pronësisë si dhe rekomandim për ndërprerje të licencës të OSHMA-së. Rastet e shqyrtuara të licencimit janë të renditura në vijim:

- OSHMA Rrokum TV - Vendim për ndryshim të pronësisë;
- OSHMA Art - Vendim për ndryshim të pronësisë;
- OSHMA Klan Kosova - Vendim për ndryshim të pronësisë;
- TV IM - Vendim për licencim të Operatorit të Shpërndarjes - platforma OTT;
- TV Premium - Vendim për ndërprerje të licencës të OSHMA-së; dhe
- Radio Classic FM - Vendim për ndryshimin e emrit dhe skemës programore.

Pas shqyrtimit të rekomandimeve të Zyrës Ekzekutive për secilin prej rasteve të lartcekura, Komisioni ka miratuar të gjitha rekomandimet.

VAZHDIMI I PUNËS NË HARTIMIN DHE AMANDAMENTIMIN E AKTEVE NËNLIGJORE

Konsultimet publike lidhur me aktet nënligjore të KPM-së

Komisioni i Pavarur i Mediave ka vazhduar punën edhe gjatë vitit 2020 në amandamentimin e legjislacionit sekondar si dhe hartimin e legjislacionit të ri sekondar në kuadër të përmbushjes së obligimeve ligjore dhe realizimit të planeve dhe objektivave vjetore.

Në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2020, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka aprovuar për dëgjim publik Draft Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

Bazuar në nenin 8, paragrafi 2, të Ligjit për KPM-në Nr. 04/L-44, KPM ka bërë ftesë publike përfaqësuesve të shërbimeve mediale audio-vizuale dhe palëve tjera të interesuara për të ofruar komente me shkrim për draft rregulloren lartpërmendur dhe t'i dërgojnë ato prej datës 3 shkurt deri më 18 mars 2020.

Ndërsa, pas zhvillimeve të reja që kanë ndodhur lidhur me situatën e krijuar me pandeminë Covid-19 dhe masave mbrojtëse të marra respektivisht shpalljes së gjendjes emergjente për shëndetin publik nga Ministria e Shëndetësisë, KPM-ja me qëllim që të ofrojë mundësi shtesë për të gjitha palët e interesuara të japin komentet e tyre me shkrim, për rregulloren e lartcekur, ka marrë vendim për zgjatjen afatit të periudhës së hapur për komente publike deri më 30 prill 2020. Por, duke pas parasysh se gjendja lidhur me shëndetin publik dhe masat mbrojtëse/kufizuese kishin mbetur të njëjta, KPM-ja ka marrë vendim për shtyrjen e afatit deri më 26 qershor 2020.

Gjithashtu, sa i përket punës në amandamentimin e legjislacionit sekondar, KPM-ja gjatë periudhës së hapur për komente publike, ka pranuar komente publike nga palët lidhur me amandamentimin e Kodit të Etikës. KPM-ja ka analizuar dhe shqyrtuar këto komente dhe pas shqyrtimit ka vendosur që propozimet e reja në Kodin e Etikës të ri-vlerësohen dhe është anuluar procedura e plotësim ndryshimit të Kodit të Etikës.

Miratimi i Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale

Në mbledhjen e mbajtur me datë 30 tetor 2020, KPM ka miratuar amandamentimin e Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

KPM-ja duke u bazuar në nenin 3, paragrafi 2, pika 11, të Ligjit për KPM-në, kishte iniciuar procedurën për amandamentimin e Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01. Ashtu siç parashihet me procedurat për nxjerrjen e legjislacionit sekondar, KPM-ja në pajtim me nenin 8 të Ligjit për KPM-në, ka vendosur në diskutim publik draftin e amandamentuar të Rregullores, ku të gjitha palët e interesuara kanë pasur mundësinë të japin komentet/vërejtjet e tyre me shkrim lidhur me draftin e Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale. Konsultimi publik ka filluar më 3 shkurt 2020 dhe ka zgjatur deri më 26 qershor 2020. Pas pranimit të komenteve

publike, KPM ka shqyrtuar të gjitha komentet dhe ato që kanë qenë të bazuara dhe argumentuara, i ka inkorporuar në draftin final.

Rregullorja për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2020/01 ka hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit dhe ka shfuqizuar Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01.

RAPORTIMI I KPM-së NË TAKIMET E DIALOGUT TË PROCESIT TË STABILIZIM ASOCIIMIT

Në kuadër të takimeve të Dialogut të Procesit të Stabilizim-Asociimit (DPSA), “Nën-komiteti i MSA-së për Inovacion, Politika sociale dhe Shoqëri Informative”, më 6 shkurt 2020 është mbajtur në Prishtinë një takim nëmes të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe zyrtarëve përfaqësues të Komisionit Evropian. Pikat e diskutimit në agjendën e takimit me KPM-në kanë qenë:

- Përafrimi i legjislacionit me Direktivën e Shërbimeve Mediatike Audio-vizive;
- Liberalizimi i dividendës së parë dixhitale / gjendjes së zbatimit; dhe
- Përditësimi i masave të marra për të zhvilluar një zgjidhje për financimin e qëndrueshëm të transmetuesit të shërbimit publik (RTK).

Gjithashtu, një takim i radhës në kuadër të DPSA-së nga “Nën-komiteti i MSA-së për Drejtësi, Liri dhe Siguri” është mbajtur më 10-11 qershor 2020, në mes të institucioneve të Republikës së Kosovës dhe zyrtarëve përfaqësues të Komisionit Evropian. Pjesëmarrës në këtë pjesë të raportimit ishin Komisioni Parlamentar për Media, Prokuroria, Policia, KPM dhe ZKM. Pikat e diskutimit në agjendën e takimit me KPM-në kanë qenë:

- Liria e shprehjes;
- Përafrimi i legjislacionit me Direktivën e Shërbimeve Mediatike Audio-vizive – propozimi për rishikimin e legjislacionit të mediave; dhe
- Hetimi i incidenteve dhe sulmeve fizike ndaj gazetarëve.

Në këto takime, përfaqësuesit e KPM-së kanë raportuar për zhvillimet institucionale, ecurinë e punës dhe harmonizimin e akteve nënligjore të KPM-së me Direktivën për Shërbimet Mediale Audiovizuale (AVMS).

PUBLIKIMET LIDHUR ME PAJTUESHMËRINË E OSHMA-VE ME AKTET NËNLIGJORE

Publikimi i Raportit të Monitorimit “Mbrotjtja e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuele”

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 31 janar 2020, ka publikuar Raportin e Monitorimit “Mbrotjtja e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audiovizuele”. Qëllimi i monitorimit të përmbajtjes programore të OSHMA-ve ka qenë vlerësimi i pajtueshmërisë së tyre me aktet nënligjore të KPM-së, sa i përket mbrotjtjes së fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuele, përshkrimi i shkeljeve të identifikuara nga monitorimi i OSHMA-ve, e që përmes këtij përshkrimi dhe rekomandimeve të këtij raporti të ndërmerren masa nga ana e OSHMA-ve për mbrotjtjen e fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e dëmshme programore dhe evitimin e ekspozimit të tyre nga përmbajtjet e tilla programore.

Komisioni i Pavarur i Mediave në mënyrë të vazhdueshme ka treguar vëmendje të posaçme sa i përket zbatimit të akteve nënligjore të KPM-së nga ana e OSHMA-ve, me qëllim të mbrotjtjes së fëmijëve dhe të miturve si kategori e ndjeshme e shoqërisë, nga përmbajtjet që mund të kenë ndikim negativ në zhvillimin e tyre fizik, mental dhe moral. Lidhur me këtë, është realizuar monitorimi i OSHMA-ve me transmetim tokësor dhe OSHMA-ve me karakter gjeneralistik që operojnë përmes OSH-ve për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre me aktet nënligjore të KPM-së që kanë të bëjnë me mbrotjtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuele.

Çështjet që kanë të bëjnë me mbrotjtjen e fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audiovizuele janë të parapara në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në dhe aktet tjera nënligjore të KPM-së, përfshirë këtu:

- KPM 2013/01 Rregulloren për Mbrotjtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele;
- KKPM-2016/03 Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës; dhe
- KPM 2017/07 Rregulloren për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuele.

Rregullorja për Mbrotjtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele në tërësi i është dedikuar mbrotjtjes së fëmijëve dhe të miturve nga përmbajtjet e programeve të cilat ndikojnë negativisht në zhvillimin e tyre fizik, mental dhe moral, përfshirë edhe mbrotjtjen e identitetit dhe respektimin e dinjitetit të fëmijëve dhe të miturve në shërbimet mediale audio dhe audiovizuele. Në bazë të kësaj Rregulloreje përcaktohet edhe mënyra e kategorizimit, sinjalizimit dhe koha e transmetimit të programeve të tilla. Raporti i plotë është tek shtojca numër IV.

BASHKËPUNIMI ME ORGANIZATA VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE

Bashkëpunimi në kuadër të Platformës Evropiane të Autoriteteve Rregullatore (EPRA)

Për shkak të situatës pandemike, aktivitetet dhe takimet e grupeve punuese në kuadër të EPRA-së janë mbajtur në mënyrë virtuale (online). Gjatë vitit 2020, KPM-ja ka qenë pjesëmarrëse në takimet në të cilat janë trajtuar tema që kishin të bëjnë me: edukimin medial, trendet e tregut medial, reklamimin e lojërave të fatit dhe bixhozit. Gjithashtu, tema tjera diskutimi kanë qenë edhe pluralizmi medial në epokën e algoritmeve, bashkëveprimi i rregullatorëve me qytetarët, ndryshimi i paradigmave të rregullatorëve të mediave si pasojë e trendëve të tregut dhe ndryshimi i kornizës ligjore, përmbajtja e fëmijëve, çështjet e konkurrencës, si dhe intelijenca artificiale dhe rregullatorët.

Konferenca regjionale e autoriteteve rregullative të mediave, në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022 – Faza II”

Komisioni i Pavarur i Mediave është institucion përfitues në Projektin e Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian “Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë 2019-2022”.

Në kuadër të këtij projekti, më 3 korrik 2020, është mbajtur tryezë diskutimi virtuale (online) me temën “Zgjedhjet, pandemia dhe dezinformimi”, me pjesëmarrës nga autoritetet rregullatore të mediave regjionale dhe ekspertë të këtyre fushave.

Bazuar në çështjet e ngritura në këtë tryezë dhe për nevojat e rregullatorëve përfitues, në shtator të vitit 2020, nga dy ekspertë ndërkombëtar të angazhuar në kuadër të këtij projekti është përgatitur një studim krahasues me reflektime mbi situatën në Evropën Juglindore me temën “Rregullimi i reklamimit politik”. Në këtë raport janë adresuar çështjet e fushatës dhe reklamimit politik nga pikëpamja e rregullatorëve, udhëzimet për standardet evropiane dhe praktikën më të mira në këtë fushë. Rregullatorët përfitues kanë kontribuar në pyetësinë e përfshirë në këtë studim.

<https://rm.coe.int/study-on-political-advertising-eng-final/1680a0c2ad>

Në kuadër të këtij projekti është duke u mbështetur edhe procesi i hartimit të Draft Rregullores për Pronësinë dhe Koncentrimin e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale. Përmes këtij projekti, në këtë proces është angazhuar edhe një ekspert ndërkombëtar.

Aktivitetet tjera të planifikuara të realizohen në kuadër të këtij projekti gjatë vitit 2020, janë shtyrë për shkak të situatës pandemike.

Vazhdimi i bashkëpunimit në mes të KPM-së dhe AMA-së

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) dhe Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) kanë zhvilluar një takim pune më 25 shtator 2020, në zyrën e AMA-së në Tiranë.

Përfaqësuesit e dy institucioneve kanë diskutuar për intensifikimin e bashkëpunimit dhe komunikimit sistematik të institucioneve, në shërbim të konsolidimit të performancës institucionale për rregullimin e tregut audiovizuel. Temë kryesore e diskutimit ishte procesi i kalimit nga transmetimi analog në atë dixhital. Gjithashtu, edhe aplikimet e reja teknologjike në

Faqe 20 nga 51

fushën e medias, mbeten aspekte ku KPM-ja dhe AMA kanë mundësi për të intensifikuar më shumë shkëmbimin e informacionit dhe përvojave, bazuar edhe në praktikën e rregullatorëve në vendet e BE-së. Një çështje tjetër që u diskutua në takim ishte edhe roli dhe impakti i transmetimeve përtej kufijve, ku transmetimet e subjekteve audiovizuale nga Shqipëria ndiqen në territorin e Republikës së Kosovës, dhe anasjelltas edhe për subjektet nga Kosova në Shqipëri. Për trajtimin e problematikave që krijohen, për ankesa të ndryshme të qytetarëve nga të dy vendet, u diskutua mundësia e realizimit të shkëmbimit të informacionit nga dy institucionet për zgjidhjen më të shpejtë dhe profesionale të tyre. Shkëmbimi i komunikimit virtual në mes të dy institucioneve ishte një pikë tjetër e diskutuar gjatë takimit, e cila u vlerësua si mekanizëm në favor të intensifikimit të bashkëpunimit dhe mbulimit të angazhimeve me interes të ndërsjellë.

Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit në mes të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Departamentit të Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) dhe Universiteti i Prishtinës (UP), më 8 janar 2020, kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi.

Nënshkrimi i një memorandumit të tillë ka ardhur si nevojë e studentëve të gazetarisë për të parë më afër funksionimin praktik të rregullimit ligjor të mediave elektronike në Republikën e Kosovës.

Qëllimi kryesor i këtij memorandumit është forcimi i mëtutjeshëm i bashkëpunimit në mes të KPM-së dhe UP-së, respektivisht Departamentit të Gazetarisë.

Ky memorandum përcakton modalitetet e bashkëpunimit në mes të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Departamentit të Gazetarisë së Universitetit të Prishtinës, respektivisht ofrohen mundësitë për studentët të Departamentit të Gazetarisë për t'u njohur me aktet normative në fuqi, që përfshijnë rregullimin e ofruesve të shërbimeve mediale audiovizuale, përfshirë: Ligjin për KPM-në dhe aktet nënligjore të KPM-së si dhe njohja me procedurat e licencimit të KPM-së, si dhe gjithë spektrin medial të të licencuarve nga KPM-ja.

Bashkëpunimi në mes të dy institucioneve respektive mundëson sigurimin e praktikës dhe ngritjes profesionale të studentëve, të cilët falë një formimi akademik më të zhvilluar, do të jenë më të përgatitur për tregun e punës. Studentët të cilët kryejnë praktikën, do t'i krijojnë vetës mundësi për të eksploruar fusha të ndryshme të karrierës që ata mund të ndjekin pas përfundimit të studimeve. Kjo praktikë do t'u mundësojë organizatorëve vlerësimin e studentëve për punësimet e mëvonshme përmes marrjes së rekomandimeve, bazuar në rezultatet e tyre gjatë praktikës.

Në koordinim me Departamentin e Gazetarisë, KPM do të ofrojë mundësi për zhvillimin e praktikës për studentët e Departamentit të Gazetarisë, duke mundësuar shfrytëzimin e kapaciteteve teknike dhe hapësirës së zyrës për hulumtime akademike të studentëve dhe stafit të Departamentit të Gazetarisë, ku zyrtarët e KPM-së do të angazhohen në ligjërata për studentët e Departamentit të Gazetarisë. Ligjëratat do të jenë të karakterit jashtë kurrikular dhe do të organizohen në kuadër të aktiviteteve të departamentit jashtë procesit mësimor. Po ashtu do të punohet në ofrimin e mundësisë për vizita studimore për studentët brenda ambienteve të punës së KPM-së, për t'u njohur nga afër me punën, procedurat dhe aktivitetet e KPM-së. Si komponentë më kryesore do të jetë bashkëpunimi në realizimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me edukimin medial, përfshirë organizimin e debateve, ligjëratave, trajnimeve dhe aktivitete tjera që ndërlidhen me fushën përkatëse.

Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit për Procesin Zgjedhor

Komisioni i Pavarur i Mediave, më 30 shtator 2020, ka marrë pjesë në nënshkrimin e Memorandumit të Bashkëpunimit për Procesin Zgjedhor, pjesë e të cilit janë edhe pesë institucione tjera: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ); Policia e Kosovës (PK); Prokurori i Shtetit (PSh); Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGjK). Organizimi i kësaj nisme për memorandumin është bërë nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D).

Qëllimi i këtij memorandumi është ngritja e nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit të vazhdueshëm institucional në mes palëve nënshkruese, për parandalimin e shkeljeve ligjore si dhe hetimin, ndjekjen dhe gjykimin efikas të të gjitha rasteve që bien ndesh me ligjet, rregullat zgjedhore apo veprat penale kundër të drejtave të votimit në të gjitha fazat e procesit zgjedhor.

Përmes këtij memorandumi, palët nënshkruese kanë synim të parandalojnë shkeljet e ligjeve dhe rregullave zgjedhore si dhe hetimin, ndjekjen dhe gjykimin e personave që kryejnë vepra penale kundër të drejtave të votimit dhe të koordinojnë veprimet ndër-institucionale për të zgjidhur rastet e lidhura me zgjedhjet në mënyrë efikase dhe transparente.

ANGAZHIMET E KPM-së GJATË PANDEMISË COVID-19

Shtyrja e afatit për raportim vjetor për të licencuarit

Raportimi vjetor është obligim ligjor për të licencuarit, i përcaktuar me Ligjin Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, respektivisht nenin 28, paragrafi 1.

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) duke pas parasysh situatën aktuale të krijuar pas paraqitjes së virusit Covid-19 në Kosovë dhe shpalljes së gjendjes emergjente për shëndetin publik nga Ministria e Shëndetësisë, ka njoftuar të licencuarit se ka shtyrë afatin për raportim vjetor.

Duke u bazuar në këtë situatë të krijuar, KPM-ja me qëllim që të ofrojë mundësi shtesë për të gjithë të licencuarit për të raportuar, ka marrë vendim për shtyrjen afatit për raportim: nga 31 mars 2020 afati është shtyrë deri më 30 qershor 2020.

Angazhimi i Komisionit të Pavarur të Mediave sa i përket raportimit të mediave në mënyrë profesionale lidhur me Covid-19

Gjatë situatës së krijuar me pandeminë Covid-19, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka dërguar thirrje publike tek të gjitha mediat që të vazhdojnë të kontribuojnë me profesionalizëm në mbulimin e zhvillimeve rreth kësaj gjendjeje me pandeminë. Duke çmuar lartë angazhimin e të gjithë gazetarëve dhe Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA), të cilët kontribuojnë në informimin e drejtë të publikut, dhe duke inkurajuar të gjithë gazetarët të bëjnë punën e tyre në mënyrë sa më profesionale. Duke vlerësuar angazhimin e të licencuarve gjatë

raportimit dhe mbulimit të situatës së krijuar nga përhapja e Covid-19, KPM ka theksuar se roli i mediave në mbulimin e ngjarjeve të tilla, siç po ballafaqohet edhe vendi, është dhe mbetet thelbësor. KPM i ka udhëzuar të gjitha OSHMA-të që gjatë raportimit, të sigurohen se të dhënat e transmetuara të jenë të verifikuara dhe të bazuara në informacionet zyrtare, duke vepruar kështu sipas standardeve profesionale të gazetarisë. Gjithashtu, mediat janë udhëzuar që të respektohet privatësia e individëve të prekur me virusin Covid-19, duke u bazuar në standardet e Kodit të Etikës për OSHMA-të, ku rëndësi të posaçme gjatë periudhës së pandemisë ka informimi i drejtë i qytetarëve duke pas për qëllim edukimin e tyre lidhur me mbrojtje dhe trajtimin e Covid-19, përfshirë marrjen e masave parandaluese, masave mbrojtëse dhe udhëzimet që kanë të bëjnë me mbrojtjen shëndetësore dhe higjienike ndaj Covid 19.

Bashkëpunimi me Misionin e OSBE-së në Kosovë

Në kuadër të bashkëpunimit të KPM-së me Misionin e OSBE-së në Kosovë, është zhvilluar një punëtori 4 ditore, ku pjesëmarrës ishin 15 zyrtarë nga Zyra Ekzekutive e KPM-së, përfaqësues nga OSBE-ja dhe ekspert të fushës së medias të angazhuar si ligjërues në punëtori. Qëllimi i kësaj punëtorie ishte prezantimi i zhvillimeve më të reja në fushën e mediave.

Tema e parë që është trajtuar në punëtori ishte “Edukimi Medial dhe Informativ (EMI)”, ku pjesëmarrësit patën rastin të informohen me trendet më të reja të zhvillimeve në fushën e mediave, përfshirë ndryshimet teknologjike, të cilat kanë sjellë nevojën për një rregullim të ri audiovizuel, përfshirë këtu sidomos çështjen e mbrojtës nga lajmet e rrejshme.

Tema tjetër që u trajtua në punëtori ishte “Prania në media sociale dhe krijimi i audiencës”. Në këtë pikë është prezantuar roli dhe rëndësia e rrjeteve sociale, fuqia e tyre në rritje gjatë viteve të fundit si dhe konkurrencën që disa rrjetet sociale po i bëjnë mediave tradicionale.

Tema e tretë në këtë punëtori ishte “Komunikimi me media”. Në këtë temë janë prezantuar rregullat lidhur me teknikën e komunikimit të institucioneve me mediat, veçanërisht e rregullatorit në rastin e KPM-së.

Organizmi i tryezës konsultative me mediat e licencuara lidhur me hartimin e Draft Rregullores për Pronësinë dhe Koncentrimin e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) në bashkëpunim me Projektin “Liria e shprehjes dhe liria e mediave (JUFREX 2)”, më 4 nëntor 2020, kanë organizuar një tryezë diskutimi në formë virtuale (online), lidhur me Draft-Rregulloren për Pronësinë dhe Koncentrimin e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele. Pjesëmarrës në këtë tryezë kanë qenë përfaqësues nga KPM-ja, përfaqësuesi i Zyrës së KE-së në Prishtinë, përfaqësuesi i Zyrës së BE-së, një ekspert i angazhuar në këtë projekt nga Këshilli i Evropës, Asociacioni i Mediave të Pavarura Elektronike të Kosovës (AMPEK), përfaqësues të mediave dhe përfaqësues të operatorëve të shpërndarjes.

Nga ana e KPM-së është theksuar rëndësia dhe nevoja e avancimit të rregullimit të çështjes së pronësisë së mediave në tregun medial në Kosovë si dhe hapat që janë ndjekur në procesin e punës

së hartimit të draftit të Rregullores për Pronësinë dhe Koncentrimin e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale. Përfaqësuesit e KPM-së dhe eksperti i angazhuar në këtë projekt nga Këshilli i Evropës, paraqitën shembujt nga BE-ja për rregulloren mbi pronësinë dhe koncentrimin e mediave. Ndërsa pjesëmarrësit tjerë në tryezën e diskutimit patën mundësinë që të paraqesin qëndrimet dhe opinionet e tyre lidhur me draft rregulloren në fjalë si dhe të japin komente dhe sugjerime.

Në përfundim të tryezës, pjesëmarrësit janë dakorduar që të vazhdohet puna në procesin e finalizimit të draftit të Rregullores për Pronësinë dhe Koncentrimin e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale.

Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Institutit të Medias të Kosovës

Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), më 2 tetor 2020, ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Institutin e Medias të Kosovës (IMK).

Qëllimi kryesor i këtij memorandumi është forcimi i mëtutjeshëm i bashkëpunimit dhe koordinimit të vazhdueshëm në mes të KPM-së dhe mediave, respektivisht Institutit të Medias të Kosovës.

Memorandumi përcakton modalitetet, instrumentet dhe mënyrat e bashkëpunimit në mes të Komisionit të Pavarur të Mediave dhe Institutit të Medias të Kosovës, respektivisht ofrohet mundësia e realizimit të projekteve të ndryshme hulumtuese dhe analizave në temat që kanë të bëjnë me fushën e shërbimeve audiovizuale dhe organizmin e aktiviteteve të ndryshme që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve njerëzore në fushën e shërbimeve audiovizuale. IMK-ja do të angazhohet në realizimin e projekteve hulumtuese duke siguruar kapacitet njerëzor, ndërsa KPM-ja do të mundësojë shfrytëzimin e kapaciteteve teknike dhe njerëzore të zyrës, në kuadër të realizimit të projekteve të përbashkëta.

Si komponentë tjetër kryesore e këtij memorandumi është se të gjitha hulumtimet dhe analizat nga projektet e përbashkëta do të publikohen dhe të jenë shërbim të publikut dhe profesionistëve të medias.

Angazhimi i KPM-së në monitorimin e të licencuarve gjatë fushatës zgjedhore në zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut

Komisioni i Pavarur i Mediave ka vazhduar punën në monitorimin e shërbimeve mediale audiovizuale gjatë fushatës zgjedhore në zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar të Komunës së Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut. Ashtu sikur edhe në monitorimet e mediave gjatë fushatave zgjedhore të kaluara, KPM ka monitoruar mediat që e kanë përcjell fushatën zgjedhore, nëse janë duke vepruar në pajtueshmëri me legjislacionin e KPM-së, Kreun VIII të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe Udhëzuesin e KPM-së për sjelljen e mediave gjatë zgjedhjeve. Nga gjetjet e KPM-së në bazë të monitorimeve, ka rezultuar se mediat

kanë respektuar legjislacionin dhe nuk ka pasur shkelje. Gjithashtu, KPM nuk ka pranuar ndonjë ankesë ndaj mediave gjatë fushatës zgjedhore.

Angazhimi i Komisionit të Pavarur të Mediave në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës ndaj Grave

Në kuadër të 16 Ditëve të Aktivizmit kundër Dhunës ndaj Grave, më 10 dhjetor 2020, në Ditën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore (QKSGj) dhe Agjencinë për Barazi Gjinore (ABGj) kanë nënshkruar një Deklaratë të Përbashkët.

Kjo deklaratë e përbashkët e iniciuar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore, në bashkëpunim me Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Agjencinë për Barazi Gjinore është hartuar me qëllim të avancimit të barazisë gjinore në Kosovë me mediat si agjentë të ndryshimeve sociokulturore. Përmes kësaj deklarate, në pajtim me obligimet që dalin nga Kodi i Etikës për Shërbimet Mediale Audiovizuale, ndër të tjera mediat nënshkruese të kësaj deklarate zotohen që të respektojnë Kodin e Etikës gazetareske dhe t'i përfillin me përpikëri rregullat e raportimit të drejtë, të saktë dhe të paanshëm në kontekstin e barazisë gjinore dhe të punojnë në eliminimin e seksizmit dhe nxitjes së gjuhës së urrejtjes në media. Nënshkrimi i kësaj deklarate është tërësisht vullnetar, duke e respektuar lirinë e shprehjes dhe pavarësinë e mediave.

Deklarata ka qenë e hapur për nënshkrim dhe u është përcjellë të gjitha mediave për nënshkrim, të cilat në mënyrë vullnetare i marrin përsipër zotimet që dalin nga kjo deklaratë.

PUNA E ZYRËS EKZEKUTIVE

Në kuadër të KPM-së funksionon Zyra Ekzekutive si organ i dytë i këtij institucioni të pavarur. Zyra Ekzekutive udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv, e cila e ndihmon Komisionin e KPM-së në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi sipas Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në.

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, përcaktohet që Kryeshefi Ekzekutiv:

- menaxhon me nëpunësit civilë të KPM-së;
- menaxhon me financat dhe me burimet tjera të financimit;
- ofron këshilla për politikën e KPM-së;
- siguron zbatimin e vendimeve, politikave dhe masave tjera të KPM-së në mënyrë efektive; dhe
- bën koordinimin e punëve me institucionet tjera.

Në kuadër të Zyrës Ekzekutive operojnë katër (4) departamente për Rregullimin e Transmetimit dhe Departamenti i Administratës:

- Departamenti i Monitorimit dhe Analizës;
- Departamenti i Licencimit;

- Departamenti Ligjor;
- Departamenti për Menaxhim Frekuencor; dhe
- Departamenti i Administratës.

Burimet njerëzore

Personeli i Zyrës Ekzekutive janë shërbyes civilë dhe janë të miratuara gjithsej 39 pozita deri në vitin 2020. Ngritja e kapaciteteve njerëzore në Zyrën Ekzekutive, proces ky që është filluar gjatë vitit 2018, pritet të arrijë të rrisë edhe efikasitetin në punën dhe përgjegjësitë e KPM-së në kuadër të zgjerimit të fushës së kompetencës dhe trendit në rritje të numrit të të licencuarve.

DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZËS (DMA)

Departamenti i Monitorimit dhe Analizës (DMA), gjatë vitit 2020, ka vlerësuar pajtueshmërinë e të licencuarve me Ligjin dhe aktet nënligjore të KPM-së, kryesisht në bazë të ankesave të parashtruara.

Të gjitha ankesat e parashtruara në KPM, pas trajtimit nga DMA-ja, i janë rekomanduar Departamentit Ligjor për veprime të mëtejme ligjore bazuar në të gjeturat nga monitorimi.

Pajtueshmëria me Rregulloren KPM 2017/07 për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuele

Çështjet që kanë të bëjnë me transmetimin e komunikimeve komerciale audiovizuele në shërbimet mediale audiovizuele janë të parapara në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në si dhe Rregulloren KPM 2017/07 për Komunikimet Komerciale Audio-Vizuele.

Lidhur me këtë, DMA ka bërë monitorimin e OSHMA-ve me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së tyre me këtë Rregullore.

Periudha monitoruese ka përfshirë periudhën kohore shtatë (7) ditore, nga data 13 deri me 19 janar 2020, dhe është fokusuar tek programet informative, lajmet dhe emisione debatuese për çështje aktuale.

Mostra e monitorimit ka përfshirë gjashtë (6) OSHMA, prej tyre:

- Tre (3) OSHMA me transmetim tokësor nacional: RTK1, KTV dhe TV21;
- Një (1) OSHMA me transmetim tokësor lokal: TV Dukagjini; dhe
- Dy (2) OSHMA që operojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes: Klan Kosova dhe TE7.

Në shkelje të kësaj Rregulloreje janë gjetur:

KTV – në shkelje të nenit 15, për vendosje të produktit në programe për çështje aktuale;

TV21 – në shkelje të nenit 10, paragrafët 1 dhe 4, duke mos identifikuar reklamimin me mjete pamore akustike ose hapësinore gjatë edicioneve informative dhe duke transmetuar dy herë reklamim gjatë edicioneve informative;

TV Dukagjini – në shkelje të nenit 12.1, 14.3, 15, për shkak të reklamimit me ekran të ndarë, sponsorizim dhe vendosje e produktit në programe për çështje aktuale;

Klan Kosova – në shkelje të nenit 10, paragrafët 1 dhe 4, duke mos identifikuar reklamimin me mjete pamore akustike ose hapësinore gjatë edicioneve informative dhe duke transmetuar dy herë reklamim gjatë edicioneve informative, si dhe në shkelje të nenit 12, paragrafi 1, për shkak të reklamimit me ekran të ndarë në programe për çështje aktuale.

TE7 – në shkelje të nenit 12.1, 14.3, 15, për shkak të reklamimit me ekran të ndarë, sponsorizim dhe vendosje e produktit në programe për çështje aktuale.

Të gjitha Raportet e monitorimit lidhur me shkeljet e gjetura të OSHMA-ve janë proceduar për trajtim të mëtutjeshëm te Departamenti Ligjor

Pajtueshmëria me të Drejtën e Autorit

Çështjet që kanë të bëjnë me transmetimin dhe ritransmetimin e përmbajtjeve programore në shërbimet mediale audiovizuale, janë të parapara në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, Rregulloren KPM 2013/02 për të Drejtën e Autorit (e aplikueshme për OSHMA-tw) dhe Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Distribimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë (e aplikueshme për OSH-të).

Pajtueshmëria me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Distribimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë

Në fillim të vitit 2020, OSH-ve u është kërkuar të deponojnë në KPM katalogët e azhurnuar të kanaleve, marrëveshjet e reja për të drejtat e ritransmetimit të këtyre kanaleve dhe përmbajtjeve programore. Nga ky aktivitet janë siguruar të dhëna të përditësuara në lidhje me të drejtat e ritransmetimit të Operatorëve të Shpërndarjes si dhe oferta e tyre programore për qytetarët.

Gjatë vitit 2020, DMA-ja ka kryer monitorime të ndryshme lidhur me pajtueshmërinë e Operatorëve të Shpërndarjes, që kryesisht janë bërë në bazë të ankesave.

Këto ankesa për subjekt trajtimi kishin pajtueshmërinë e një numri të konsiderueshëm të Operatorëve të Shpërndarjes. Lidhur me këto raste, DMA-ja në bashkëpunim edhe me departamentet tjera, ka realizuar monitorime në terren në gjithë territorin e Republikës së Kosovës, duke verifikuar rastet e tilla, dhe më pas duke ndërmarrë veprime konkrete varësisht nga natyra e rasteve.

Lidhur me transmetimin e programeve/kanaleve apo përmbajtjeve të caktuara programore dhe me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë me këtë rregullore, OSH-ve të monitoruara u janë kërkuar

marrëveshjet valide për të drejtën e autorit, të cilat janë vlerësuar nga Departamenti Ligjor i KPM-së lidhur me vlefshmërinë e tyre.

Raportet e monitorimit lidhur me shkeljet e gjetura nga ana e Operatorëve të Shpërndarjes janë proceduar për trajtim të mëtutjeshëm te Departamenti Ligjor.

Monitorimi i lajmeve qendrore të OSHMA-ve

Duke pas parasysh rolin e mediave në përgjithësi, e në veçanti ndikimin e lajmeve në të gjitha aspektet shoqërore në përgjithësi, është realizuar monitorimi i edicioneve qendrore të OSHMA-ve, me qëllim të vlerësimit të lajmeve që i plasohen publikut nga OSHMA-të. Periudha e monitorimit ka përfshirë muajin shkurt dhe mars të vitit 2020, në të cilën janë përfshirë shtatë (7) OSHMA, prej tyre:

- Tri (3) OSHMA me mbulim tokësor nacional (RTK1, TV21 dhe KTV);
- Një (1) OSHMA me mbulim tokësor lokal (TV DUKAGJINI); dhe
- Tri (3) OSHMA që operojnë përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2, KLAN KOSOVA dhe TE7).

Metoda kualitative është përdorur për të vlerësuar nëse lajmet e transmetuara në kronika kanë qenë relevante (mbulim i ngjarjeve/temave të kohës), janë transmetuar me saktësi (përmbajtja bazuar në informata dhe fakte të verifikuara saktë), nëse është siguruar mbulim i balancuar i çështjeve me interes publik (dy ose më shumë palë të përfshira në temën/kronikën për çështje të caktuara) si dhe është bërë vlerësimi për mënyrën e prezantimit të kronikës dhe trajtimit nga gazetari/reporteri/mediumi, përfshirë paanshmërinë në zgjedhjen e gjuhës dhe imazheve.

Ndërsa, metoda kuantitative është përdorur për të nxjerrë të dhëna sa i përket hapësirës së dhënë për kategoritë e përcaktuara si:

- Politikë – që ka përfshirë veprimtarinë e: Presidentit/Presidencës; Kryeministrit/Qeverisë; Kryetarit të Kuvendit/Kuvendit të Kosovës; subjekteve politike dhe tjera të pa përfshira në nënkategoritë e sipërpërmendura.
- Ekonomi/tjera që ndërlidhen me zhvillimin ekonomik – që ka përfshirë nënkategoritë: Çështje të përgjithshme ekonomike; Bujqësi; Industri/prodhimtari; dhe tema tjera të pa përfshira më sipër që ndërlidhen me aspektin ekonomik.
- Kategori të tjera të sferave të caktuara – që ka përfshirë fusha si: Drejtësi/Sundim i Ligjit; Siguri; Sociale; Art/Kulturë/Edukim; Shëndetësi; dhe të tjera të pa përfshira në nënkategoritë më sipër.
- Lajmet ndërkombëtare – që ka përfshirë hapësirë e dhënë për lajmet nga: Rajoni, Evropa dhe Bota në përgjithësi.
- Sport – që ka përfshirë lajmet rreth sportit vendor dhe ndërkombëtar.

Sa i përket aspektit gjinor, është përcaktuar që të nxirren të dhëna sasiore sipas gjinisë në bazë të:

- numrit të moderimit/udhëheqjes;

- numrit të editimit/redaktimit të lajmeve;
- hapësirës së dhënë në kategorinë e sportit; dhe
- prezantimin e tri kronikave të para të edicioneve qendrore.

Ndërsa, gjatë periudhës së muajit mars 2020, fokus i monitorimit ishte edhe mbulueshmëria e situatës pandemike në edicionet e lajmeve qendrore, ku është matur edhe hapësira e dhënë në kronikat që kanë trajtuar temën e COVID19, e ndërlidhur me fushat dhe ndikimit në këto fusha si në vijim: ekonomi; shëndetësi; siguri; sociale; sport dhe kulturë; raportim rreth situatës jashtë Kosovës dhe të tjera.

Raporti i plotë në Shtojcën V “Monitorimi i lajmeve qendrore të OSHMA-ve”.

Zgjedhjet për kryetar të komunave

KPM-ja është përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të Kreut VIII të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili vlen edhe për Zgjedhjet Lokale, përkatësisht për zgjedhjet për kryetarë të komunave të Kosovës.

Gjatë vitit 2020, janë zhvilluar zgjedhjet për kryetar të Komunës së Podujevës, të cilat janë anuluar në muajin mars për shkak të situatës së pandemisë por janë mbajtur më pas në nëntor të vitit 2020, së bashku me zgjedhjet për kryetar të Komunës së Mitrovicës së Veriut.

Para fillimit të fushatave zgjedhore, KPM-ja ka përcjell tek të licencuarit e saj materialet për zgjedhje, përfshirë: Udhëzuesin e KPM-së për Sjelljen e Mediave gjatë Zgjedhjeve, Ditarët për emetimet me dhe pa pagesë, Udhëzuesin për plotësimin e Ditarëve dhe Kreun VIII të Ligjit për Zgjedhje.

Zgjedhjet për kryetar të Komunës së Podujevës, mars 2020

Zgjedhjet për kryetar të Komunës së Podujevës ishin të planifikuara të mbaheshin nga data 03 deri më 15 mars 2020.

Lidhur me këto zgjedhje, DMA ka monitoruar përmbajtjet programore të emetuara para fillimit të fushatës zgjedhore (18 shkurt – 02 mars 2020) dhe gjatë fushatës zgjedhore (03-11 mars 2020) në OSHMA-të: RTK1, RTK2, TV LLAPI, KTV, TV 21, TV Dukagjini, Klan Kosova dhe TE 7.

Për shkak të situatës së pandemisë, zgjedhjet janë anuluar dhe monitorimi është ndërprerë më datën 12 mars 2020.

Zgjedhjet për kryetar të Komunës së Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut, nëntor 2020

Fushata zgjedhore për zgjedhjet në Komunën e Podujevës ka zgjatur nga data 23 deri më 27 nëntor 2020, në Komunën e Mitrovicës së Veriut nga data 12 deri më 27 nëntor 2020, ndërsa zgjedhjet janë mbajtur më 29 nëntor 2020.

DMA-ja ka bërë monitorimin e ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele (OSHMA) të cilat kanë mbuluar fushatën e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kryetarë të Komunës së Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut.

Në monitorim janë përfshirë dhjetë (10) ofrues të shërbimeve mediale audio-vizuele, prej të cilëve:

- Tri (3) me mbulim tokësor nacional (RTK1, KTV dhe TV21);
- Katër (4) OSHMA me mbulim tokësor lokal/regjional (TV Dukagjini, TV Most, TV Mitrovica dhe TV Mir); dhe
- Tre (3) OSHMA me program gjeneralistik që transmetohen përmes operatorëve të shpërndarjes (RTK2, Klan Kosova, TE7).

Gjatë procesit të monitorimit, në fokus ishin të gjitha format e prezantimit medial të fushatës zgjedhore si: edicionet e lajmeve, pikat politike reklamuese, kronikat zgjedhore dhe intervistat e debatet e transmetuara nga ora 16:00 deri në orën 24:00.

Gjatë periudhës monitoruese është vlerësuar: paanshmëria në raportim, hapësira e ofruar për kandidatët, gjuha e përdorur dhe, në përgjithësi, pajtueshmëria me Ligjin për Zgjedhje, Ligjin e KPM-së dhe aktet nënligjore përkatëse të KPM-së.

Raporti i plotë në Shtojcën VI “OSHMA-të gjatë fushatës për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Podujevës dhe Mitrovicës së Veriut 2020”.

Vizitat në terren

Gjatë vitit 2020, DMA-ja në bashkëpunim me departamentet përkatëse ka realizuar disa vizita në terren, me qëllim të vlerësimit të gjendjes në aspektin e transmetimit analog të ofruesve të shërbimeve mediale audio-vizuele, përkatësisht tek OSHMA-të që kanë pasur ndërprerje të shpeshta të transmetimit.

Vizitat në terren janë realizuar edhe me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së OSH-ve me Rregulloren për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së për Distribimin Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë. Lidhur me këtë janë realizuar tri (3) vizita në terren:

- Ankesa e OSH IPKO ndaj OSH J@B NET, Pejë;
- Ex Officio ndaj OSH KUMANNOVA CABLE, Suharekë; dhe
- Ankesa e OSH IPKO ndaj ARTMOTION, Prishtinë.

Ndërsa, për rastet e ankesave për veprimtari ilegale të OSH-ve, janë realizuar katër (4) vizita në terren:

- Ankesa e OSH TELKOS ndaj SMS, për veprimtari ilegale në Podujevë;
- Ankesa e TRING TV ndaj GIGA GROUP, për veprimtari ilegale në Gjilan;
- Ankesa e TRING TV ndaj ARTVISION, për veprimtari ilegale në Rahovec; dhe
- Ankesa e OSH IPKO ndaj PLANET, për veprimtari ilegale në Suharekë.

Në bazë të të gjeturave nga monitorimi, për ankesat e trajtuara janë dhënë rekomandimet për veprime të mëtejme ligjore.

DEPARTAMENTI I LICENCIMIT

Numri i përgjithshëm i të licencuarve në Republikën e Kosovës

Departamenti i Licencimit është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave për licenca të reja për ofrues të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, përfshirë edhe shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me ndryshime të kushteve të licencës së KPM-së. Gjithashtu, Departamenti i Licencimit është përgjegjës për mirëmbajtjen e një regjistri për të gjithë të licencuarit e KPM-së. Kështu, gjatë vitit 2020 kanë operuar gjithsej 19 TV Stacione, 89 Radio Stacione, 41 Operator të Shpërndarjes dhe 94 Ofrues të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (OSHMA), të cilët ofrojnë programet e tyre vetëm përmes rrjetit të Operatorëve të Shpërndarjes.

Numri i TV dhe Radio stacioneve të licencuara sipas gjuhëve:

Të licencuara 19 TV stacione:

- 1 TV stacion publik;
- 13 TV stacione në gjuhën shqipe;
- 5 TV stacione në gjuhën serbe.

Të licencuara 89 Radio stacione:

- 2 radio stacione të transmetuesit publik;
- 56 radio stacione në gjuhën shqipe;
- 22 radio stacione në gjuhën serbe;
- 3 radio stacione në gjuhën boshnjake;
- 2 radio stacione në gjuhën turke;
- 2 radio stacione në gjuhën gorane;
- 1 radio stacion në gjuhën rome;
- 1 radio stacion multietnik.

Numri i Operatorëve të Shpërndarjes (OSH) të licencuar:

Të licencuar 41 operatorë të shpërndarjes:

- 34 operatorë të shpërndarjes të licencuar me pronarë shqiptar;
- 2 operatorë të shpërndarjes të licencuar me pronarë boshnjak/goran;
- 5 operatorë të shpërndarjes të licencuar me pronarë serb.

Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (OSHMA) të cilët transmetojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes

Gjithsej janë të licencuar 94 Ofrues të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale (OSHMA), të cilët ofrojnë programet e tyre vetëm nëpërmjet rrjetit të operatorëve të shpërndarjes.

- 83 OSHMA janë të licencuar të transmetojnë program në gjuhën shqipe;
- 8 OSHMA janë të licencuar të transmetojnë program në gjuhën serbe;
- 3 OSHMA janë të licencuar të transmetojnë program në kuadër të Transmetuesit Publik RTK (RTK 2; RTK News dhe RTK Art).

Shqyrtimi i kërkesave

Gjatë vitit 2020, Departamenti i Licencimit (D-LIC) ka regjistruar 56 raste për shqyrtim, e të cilat kanë të bëjnë me: kërkesa për licencë të OSHMA-ve me transmetim përmes operatorëve të shpërndarjes, kërkesa për licencë të operatorëve të shpërndarjes, kërkesë për ndryshimin e emrit të subjektit të licencuar, kërkesat për ndryshim të pronësisë, kërkesa për ripërtëritje të licencës, njoftime për heqje dorë nga licenca, kërkesa për ndryshim të skemës programore si dhe raste të tjera që lidhen me kushtet dhe termet e përgjithshme dhe ato teknike të licencës së KPM-së.

D-LIC ka përgatitur rekomandimet për rastet e licencimit, të cilat i ka prezantuar para anëtarëve të KPM-së për shqyrtim dhe mbi bazën e atyre rekomandimeve janë marrë vendime.

Në përgjithësi, gjatë vitit 2020 janë marrë këto vendime për licencim:

- 8 vendime për licencimin e OSHMA-ve të cilat transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes;
- 3 vendime për licencimin e Operatorëve të Shpërndarjes;
- 5 vendime për ripërtëritje të licencës;
- 4 vendime për ndërprerje të licencës si rezultat i heqjes dorë në mënyrë vullnetare nga licenca e KPM-së (3 Operatorë të Shpërndarjes dhe 1 OSHMA me transmetim përmes Operatorëve të Shpërndarjes);
- 2 vendime për ndërprerje të licencës (2 OSHMA me transmetim përmes Operatorëve të Shpërndarjes - ex officio, me njërin nga vendimet janë ndërprerë 8 licenca të OSHMA-ve me transmetim përmes Operatorëve të Shpërndarjes të cilat kanë qenë në pronësi të një biznesi);
- 4 vendime për ndryshim të pronësisë (me dy nga vendimet, përveç pronësisë është ndryshuar edhe emri dhe skema programore e të licencuarit;
- 1 vendim për ndryshimin e skemës programore dhe emrit të të licencuarit;
- 1 vendim për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit.

Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2021, ato të bartura tek Departamenti Ligjor dhe rastet e mbyllura pa nevojë për vendim të Komisionit:

- Rastet që janë bartur për shqyrtim në vitin 2021, janë gjithsej 17 raste;
- Rastet që janë bartur për trajtim nga Departamenti Ligjor janë gjithsej 4 raste;
- Rastet të cilat janë mbyllur pa pasur nevojë për vendim të Komisionit, gjithsejtë 6 raste (pasi që të licencuarit kanë ardhur në pajtueshmëri me kushtet e licencës së tyre).

DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2020 ka shqyrtuar raste të ndryshme të Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audiovizuale (tutje OSHMA) dhe Operatorëve të Shpërndarjes (tutje OSH) për shkelje të dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, dhe akteve nënligjore të KPM-së. Departamenti Ligjor gjatë vitit 2020 ka shqyrtuar edhe raste tjera në bazë të ankesave të personave fizik dhe juridik të parashtruara kundër OSHMA-ve dhe OSH-ve.

Rastet e proceduara në bazë të shkeljeve të dispozitave ligjore të Ligjit për KPM-në dhe akteve nënligjore të KPM-së³ janë kategorizuar dhe paraqitur si në vijim:

Rastet për transmetim ilegal - Shkelja e nenit 21, paragrafi 1, dhe nenit 30, paragrafi 5, të Ligjit 04/L-44 për KPM-në

Gjatë vitit 2020, Departamenti Ligjor ka proceduar tri (3) raste për shkelje të nenit 21, paragrafi 1, të Ligjit për KPM-në, i cili përcakton se: “Për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij Ligji kërkohet licenca për transmetim të cilin e lëshon KPM-ja”, dhe nenit 30, paragrafi 5, i Ligjit të KPM-së, i cili përcakton se: “Kushdo që operon pa leje transmetimi valide, i konfiskohet aparatura përkatëse për transmetim. Subjekti i tillë transmetues nuk mund të ankohet tek Bordi për Ankesa”.

Departamenti Ligjor i KPM-së i ka dërguar Njoftim për Shkelje Operatorëve të Shpërndarjes VGN, KDS SAT dhe IMPULS për operim ilegal. Këta operatorë kanë dështuar të veprojnë në pajtueshmëri për t’u pajisur me licencë të KPM-së. Këto raste janë bartur për vitin 2021.

Rastet e Shkeljes së Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në, nenit 28 - Mos sjellja e Raportit vjetor

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2020 ka proceduar njëzet e gjashtë (26) raste për mos sjellje të raportit vjetor. Të gjithë të licencuarve të cilët kanë dështuar të veprojnë në pajtim me nenin 28 të Ligjit për KPM-së u janë dërguar Njoftime për shkelje si veprim i parë procedural dhe njoftues. Pas dërgimit të Njoftimit për shkelje nga ana e Departamentit Ligjor, tetë (8) nga këto OSHMA kanë ardhur në pajtueshmëri dhe si raste janë mbyllur. Ndërsa, për tetëmbëdhjetë (18) OSHMA tjera, Komisioni i KPM-së ka marr këto Vendime: dhjetë (10) prej tyre me masë sanksionuese në shumën prej njëmijë (1000) euro, ndërsa tetë (8) tjera me masë sanksionuese Vërejtje. Rastet janë mbyllur.

Rastet për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM -2017/07

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2020 ka proceduar pesë (5) raste ex officio ndaj OSHMA-ve për shkelje të Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuale KPM-2017/07. Këto subjekte kanë pranuar Njoftime për shkelje si veprim i parë procedural dhe njoftues. Ndërsa tri (3) raste të tjera janë trajtuar sipas ankesave, një nuk është gjetur në shkelje dhe dy janë bartur për vitin 2021.

³ Shih Shtojcën II “Paraqitja Tabelare e Rasteve Ligjore”

Rastet për shkelje të Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele KPM- 2013/01

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2020 ka proceduar një (1) rast (ankesë) kundër OSHMA-së lidhur me shkeljen e Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele KPM 2013/01. OSHMA ka pranuar Njoftimin për Shkelje si veprim i parë procedural dhe njoftues. Pas pranimit të Njoftimeve për Shkelje, OSHMA ka ardhur në pajtueshmëri me Rregulloren për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale Audio-Vizuele KPM 2013/01 dhe është mbyllur si rast ligjor.

Rastet e shkeljes së Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2020 ka proceduar tri (3) raste kundër OSHMA-ve lidhur me shkeljen Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03. Dy (2) prej tyre kanë pranuar Njoftime për Shkelje si veprim i parë procedural dhe kanë ardhur në pajtueshmëri dhe si raste janë mbyllur. Ndërsa, një (1) ka qenë kërkesë nga Avokati i Popullit ku kanë kërkuar sqarime lidhur me disa rastet dhe për këtë iu është kthyer përgjigje.

Rastet për shkeljen e Rregullores për Tarifën Vjetore për Licencë KPM-2017/06 - Mos pagesa e taksës për licencë dhe gjobat e shqiptuar nga Komisioni i KPM-së.

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2020 i ka dërguar në përmbardim njëqind e dy (102) Ofrues të Shërbimeve Mediale Audiovizuale të cilat nuk e kanë paguar tarifën për licencë për vitin 2020. Po ashtu, në përmbardim janë dërguar edhe dymbëdhjetë (12) raste për mos pagesë të gjobave të shqiptuara nga Komisioni i KPM-së.

Rastet për shkeljen Rregullores për Shpërndarjen e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2016/01 dhe Rregulloren KPM-2020/01 e cila ka hyr në fuqi me datën 3 nëntor 2020

Departamenti Ligjor gjatë vitit 2020 ka proceduar dyzet e tri (43) raste të shkeljeve dhe ankesave të Operatorëve të Shpërndarjes (OSH).

Departamenti Ligjor iu ka dërguar disa prej tyre Njoftime për Shkelje dhe të tjera edhe përgjigje në ankesa pas konstatimit nga KPM-ja se nuk kanë vepruar në kundërshtim me Rregulloren KPM-2020/01.

Departamenti Ligjor ka rekomanduar tek Komisioni vetëm për dy (2) raste: OSH J@B NET dhe KUMANNOVA CABLE, të cilët janë sanksionuar me gjobë në shumë prej dy mijë (2.000) euro për shkelje të Rregullores KPM-2016/01. Ndërsa, shtatë (7) prej këtyre rasteve janë bartur për vitin 2021.

Rastet dhe Kërkesat tjera të proceduara nga KPM-ja gjatë vitit 2020, rastet e shkeljes së Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03

Janë proceduar njëzet e tri (23) raste:

1. Rasti i parë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Haki Abazi ndaj OSHMA KTV. Ankesa i referohet kronikës “*Biseda*”, ku ka qenë i ftuar z. Frashër Krasniqi, e transmetuar në emisionin Interaktiv në KTV. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se i ftuari në emision në KTV ka përdor fjalë denigruese dhe ka bërë akuza të pabazuara në vazhdimësi dhe se moderator i emisionit nuk e ka ndaluar. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e kronikës dhe ka gjetur se KTV ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje KTV-sw. Edhe pas Njoftimit për Shkelje, KTV ka dështuar të veproj në pajtim me Kodin KKPM 2016/03. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së, Komisioni i KPM-së mori Vendim që KTV të sanksionohet me Vërejtje. Rasti është mbyllur.
2. Rasti i dytë është proceduar bazuar në Ankesën e znj. Arta Sada Fetiu ndaj OSHMA TE7. Ankesa i referohet kronikës “*Mësuesja akuzohet për dhunë ndaj nxënësve*“, e transmetuar në emisionin informativ Frontal në TE7. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se TE7, konkretisht gazetari i emisionit ka keqpërdorur autorizimet e tij si gazetar duke përgatitur kështu kronikë e cila në vete përmban lajm dhe kritikizëm të pavërtetë me qëllim të njollosjes së emrit. KPM me qëllim të shqyrtimit të Ankesës ka bërë monitorimin e programit dhe ka gjetur se TE7 ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje TE7-it. Pas Njoftimit për Shkelje, TE7 ka vepruar në pajtim me Kodin KKPM 2016/03. Palës ankuese i është kthyer përgjigje. Rasti është mbyllur.
3. Rasti i tretë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Haki Abazi ndaj OSHMA Klan Kosova. Ankesa i referohet emisionit “Zona B”, i transmetuar në Klan Kosova. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se gazetari ka përdorur gjuhë që nxit urrejtje dhe ka bërë fyerje dhe akuza të pabazuara. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se Klan Kosova ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje KTV-sw. Edhe pas Njoftimit për Shkelje, Klan Kosova ka dështuar të veproj në pajtim me Kodin KKPM 2016/03. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së, Komisioni i KPM-së mori Vendim që të sanksionojë Klan Kosova me Vërejtje dhe që në afat prej shtatë (7) ditëve t’i ofrojë Palës Ankuese mundësinë për të ofruar sqarimet dhe qëndrimet e veta lidhur me rastin. Rasti është mbyllur.
4. Rasti i katërt është proceduar bazuar në Ankesën e z. Skender Klaiqi ndaj OSHMA RTK 1. Ankesa i referohet emisionit “Special”, i transmetuar në RTK1. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se në këtë emision është prezantuar Shukri Ymeri, i cili ka folur

për Lobin Euroatlantik Shqiptar. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se RTK1 ka vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03. Palës Ankuese i është kthyer përgjigje. Rasti është mbyllur.

5. Rasti i pestë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Çlirim Hajdini ndaj OSHMA TV Dukagjini. Ankesa i referohet emisionit “IN DOKS”, i transmetuar në TV Dukagjini. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se gjatë transmetimit të emisionit janë përdorur shprehje jo adekuate, denigruese për Policinë e Kosovës me të cilin janë paraqitur të dhëna personale përmes filmimeve pa miratim paraprak. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se TV Dukagjini ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje TV Dukagjini-t. Pas Njoftimit për Shkelje, TV Dukagjini i ka ofruar Palës Ankuese mundësinë për t'i ofruar sqarimet dhe qëndrimet e veta lidhur me rastin. Rasti është mbyllur.
6. Rasti i gjashtë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Agron Rukiqi ndaj OSHMA TV Dukagjini. Ankesa i referohet emisionit “IN DOKS” të transmetuar në TV Dukagjini. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se gjatë transmetimit të emisionit janë përdorur shprehje dhe jo adekuate, denigruese për Policinë e Kosovës e me të cilin janë paraqitur të dhëna personale përmes filmimeve pa miratim paraprak. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se TV Dukagjini ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje TV Dukagjini-t. Pas Njoftimit për Shkelje, TV Dukagjini i ka ofruar Palës Ankuese mundësinë për t'i ofruar sqarimet dhe qëndrimet e veta lidhur me rastin. Rasti është mbyllur.
7. Rasti i shtatë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Bashkim Spahiu ndaj OSHMA TV Dukagjini. Ankesa i referohet emisionit “IN DOKS” të transmetuar në TV Dukagjini. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se gjatë transmetimit të emisionit janë përdorur shprehje dhe jo adekuate, denigruese për Policinë e Kosovës e me të cilin janë paraqitur të dhëna personale përmes filmimeve pa miratim paraprak. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se TV Dukagjini ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje TV Dukagjini-t. Pas Njoftimit për Shkelje, TV Dukagjini i ka ofruar Palës Ankuese mundësinë për t'i ofruar sqarimet dhe qëndrimet e veta lidhur me rastin. Rasti është mbyllur.
8. Rasti i tetë është proceduar bazuar në Ankesën e OSHMA RTK 1 ndaj OSHMA Klan Kosova. Ankesa i referohet emisionit “Oxygen” të transmetuar në Klan Kosova. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se gjatë transmetimit të emisionit i ftuari i emisionit ka akuzuar pa bazë dhe ka përhapur të pavërteta për palën ankuese. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se Klan Kosova ka vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, pasi që është kërkuar falje publike në emisionin

Faqe 36 nga 51

nga moderatori i emisionit “Oxygen” z. Besim Dina. Palës Ankuese i është kthyer përgjigje. Rasti është mbyllur.

9. Rasti i nëntë është proceduar bazuar në Ankesën e Familjes Mustafa ndaj OSHMA TE7. Ankesa i referohet kronikës ”Punëtori bie nga kati i katërt në Prishtinë” të transmetuar në Klan Kosova. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se gjatë transmetimit të kronikës është cekur se punëtori bie nga kati i katërt i ndërtesës përderisa personi ka qenë familjar i tyre dhe se nuk ka qenë punëtor mirëpo vizitor. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se Klan Kosova ka vepruar në pajtueshmëri me Kodin e Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, pasi që i ka ofruar Palës ankuese të drejtën e reagimit në afat prej shtatë (7) ditësh. Palës Ankuese i është kthyer përgjigje. Rasti është mbyllur.
10. Rasti i dhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Faton Thaçi ndaj OSHMA KTV. Ankesa i referohet kronikës “Shpronësimet në Malishevë” të transmetuar në KTV. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se në kronikë janë prezantuar lajme të pabazuara në fakte duke apostrofuat emrin e tij kinse si person nën hetime duke bërë kështu gjykim publik. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se KTV ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje KTV-sw. Edhe pas Njoftimit për Shkelje, KTV ka dështuar të veprojë në pajtim me Kodin KKPM 2016/03. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së, Komisioni i KPM-së mori Vendim që të sanksionojë KTV-nw me Vërejtje që në afat prej shtatë (7) ditësh t’i ofrojë Palës Ankuese mundësinë e reagimit në hapësirë dhe kohë të njëjtë. Pala Ankuese ka bërë ankesë edhe në Bordin për Ankesa. Rasti është bart për vitin 2021.
11. Rasti i njëmbëdhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Bojan Stamenkovic ndaj OSHMA Klan Kosova. Ankesa i referohet emisionit “ORA 7” të transmetuar në Klan Kosova. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se në emision është prezantuar storie nga fotografi z. Bujar Gashi cili ka prezantuar fotografin e manastirit e Moqares dhe kishës së Vaganeshit duke pretenduar se janë shqiptare. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se Klan Kosova nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, pasi që nuk e ka transmetuar atë storie. Palës ankuese i është kthyer përgjigje. Rasti është mbyllur.
12. Rasti i dymbëdhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e Devolli Group ndaj OSHMA RTK 1. Ankesa i referohet emisionit “Jeta në Kosovë” me titull “*Monopoli me dritë të diellit ZRRE dhe Devolli Group*” të transmetuar në RTK 1. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se gjatë gjithë transmetimit të këtij emisioni përdoret një gjuhë denigruese me qëllim të dëmtimit të imazhit të kompanisë dhe emrit të tij duke përdorur fraza si “Baba Blerim Devolli”, “Nanë Blerim Devolli”, dhe në disa raste përmendet “skema e fshehjes së pronarëve të vërtetë”, e cila është e pavërtetë dhe tendencë për të paraqitur emrin tim si të inkriminuar në punë të jashtëligjshme si përfitues nga “xhepi i konsumatorit”, duke përdorur fraza me të cilat mundohet të bindë shikuesin për diçka që nuk qëndron. KPM me

qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se RTK 1 ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje RTK 1. Edhe pas Njoftimit për Shkelje, RTK 1 ka dështuar të veproj në pajtim me Kodin KKPM 2016/03. Në bazë të Rekomandimit të Zyrës së KPM-së Komisioni i KPM-së mori Vendim që të sanksionojë RTK 1 me Vërejtje. Pala Ankuese ka bërë ankesë edhe në Bordin për Ankesa. Rasti është bart për vitin 2021.

13. Rasti i trembëdhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e Federatës së Sindikatave të Pavarura të Kosovës (FSPE) ndaj OSHMA KTV. Ankesa i referohet kronikës “Puna në KEDS” të transmetuar në KTV. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se në kronikë është transmetuar z. Rashit Gashi i cili nuk ka rol aktiv në sindikatë. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e kronikës dhe ka gjetur se KTV nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, pasi që e ka transmetuar reagimin e FSPE-së. Palës ankuese i është kthyer përgjigje. Rasti është mbyllur.
14. Rasti i katërbëdhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Eset Berisha ndaj OSHMA KTV. Ankesa i referohet emisionit “Raport” të transmetuar në KTV. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se gjatë transmetimit të emisionit është bërë sulm personal duke akuzuar se ka pasur ndikim në vendimin e Ministrisë së Infrastrukturës pasi që ka qenë këshilltar i ministrit. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se KTV ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje KTV-së. Pas Njoftimit për Shkelje, KTV i ka ofruar Palës Ankuese mundësinë për t’i ofruar sqarimet dhe qëndrimet e veta lidhur me rastin. Rasti është mbyllur.
15. Rasti i pesëmbëdhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Gëzim Saraçi ndaj OSHMA TV Dukagjini. Ankesa i referohet emisionit “Jeta në Komuna” të transmetuar në TV Dukagjini. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se në emision ku ka qenë i ftuar z. Xhafer Tahiri është diskutuar për hapësirën e qendrës së kulturës e cila menaxhohet nga ai dhe se gjatë bisedës është bërë shpifje ndaj tij. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se TV Dukagjini nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03. Palës ankuese i është kthyer përgjigje. Rasti është mbyllur.
16. Rasti i gjashtëmbëdhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e Orange Net ndaj OSHMA Klan Kosova. Ankesa i referohet lajmeve qendrore të transmetuar në Klan Kosova. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se është bërë një lajm se disa operatorë kabllorë, ndër ta edhe Orange Net, janë duke e transmetuar në mënyrë ilegale kanalën Klan Kosova. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se Klan Kosova ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje Klan Kosova. Edhe pas Njoftimit për Shkelje, Klan Kosova ka dështuar të veproj në pajtim me Kodin KKPM 2016/03. Rasti është bartur për vitin 2021.

17. Rasti i shtatëmbëdhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Migjen Kelmendi ndaj OSHMA TV Dukagjini. Ankesa i referohet emisionit “Debat Plus” të transmetuar në TV Dukagjini. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se në emision moderatori shfaq foto në ekran duke cekur se znj. Tefta Kelmendi Meran është emëruar politikisht në sajë të prindit të saj duke aluduar se emërimet janë bërë në baza politike. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se TV Dukagjini nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03. Palës ankuese i është kthyer përgjigje. Rasti është mbyllur.
18. Rasti i tetëmbëdhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e z. Migjen Kelmendi ndaj OSHMA KTV. Ankesa i referohet lajmeve të mbrëmjes të orës 19:00 të transmetuar në KTV. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se në lajme është transmetuar kronika lidhur me emërimin e znj. Tefta Kelmendi duke cekur se emërimi i saj është bërë në sajë të emrit të tij. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se KTV nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03. Palës ankuese i është kthyer përgjigje. Rasti është mbyllur.
19. Rasti i nëntëmbëdhjetë është proceduar bazuar në Ankesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) ndaj OSHMA KTV. Ankesa i referohet kronikës “Gradimet në MPJD” e transmetuar në KTV. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se kronika nuk e paraqet realitetin duke u munduar ta nxjerrë gradimin e znj. Oruqi si të kundërligjshëm sipas kronikës, duke bërë fyerje dhe keq informuar publikun me lajme të pavërteta. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se KTV ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje KTV-së dhe me këtë njoftim ka kërkuar t’i jepet e drejta e reagimit Palës ankuese në afat prej shtatë (7) ditësh. Palës ankuese i është kthyer përgjigje. Rasti është mbyllur.
20. Rasti i njëzet është proceduar bazuar në Ankesën e z. Diellor Gashi ndaj OSHMA KTV. Ankesa i referohet kronikave “Granti 5.2 milionësh” dhe “Shpëtimi i 5.2 milionshit” të transmetuar në edicionet e lajmeve të mbrëmjes në KTV. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se në kronika janë transmetuar të pavërteta të shumta për vlerësimin e grantit të performancës komunale duke dëmtuar kështu personalitetin e tij, duke cekur se ka pasur abuzime dhe manipulime të të dhënave nga zyrtarë të Ministrisë së Pushtetit Lokal duke e përmendur emrin e tij.. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e kronikave dhe ka gjetur se KTV ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03, dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje KTV-së. Me anë të njoftimit është kërkuar në afat prej shtatë (7) t’i ofrohet Palës Ankuese mundësia e reagimit lidhur me rastin. Rasti është mbyllur.
21. Rasti i njëzetë e një është proceduar bazuar në Ankesën e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) ndaj OSHMA Kanal 10. Ankesa i referohet emisionit “Mëngjesi me Arbenin”, konkretisht kronikës “Kush i solli BMW 7 tek Ministria e Jashtme”, të

transmetuar në Kanal 10. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se në emision janë transmetuar të pavërteta duke keq informuar publikun në lidhje me gjendjen reale të çështjes së blerjes së veturave BMW. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se KANAL 10 nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03. Palës ankuese i është kthyer përgjigje. Rasti është mbyllur.

22. Rasti i njëzetë e dy është proceduar bazuar në Ankesën e OSHMA RTK 1 ndaj OSHMA TV Dukagjini. Ankesa i referohet emisionit “Jeta në Kosovë” të transmetuar në TV Dukagjini. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se në emision moderatorja gjatë bisedës me të ftuarin Fadil Hoxha ka bërë shpifje dhe atë me vetëdije të plotë duke e dëmtuar reputacionin e RTK 1. KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se TV Dukagjini ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03 dhe për këtë KPM i ka dërguar Njoftim për Shkelje TV Dukagjini-t dhe me anë të njoftimit është kërkuar në afat prej shtatë (7) ditës t’i ofrohet Palës Ankuese mundësia e reagimit lidhur me rastin. Rasti është mbyllur.

23. Rasti i njëzet e tre është proceduar bazuar në Ankesën e z. Haki Abazi ndaj OSHMA TE7. Ankesa i referohet emisionit “Pressing” të transmetuar në TE 7. Pala ankuese ka bërë ankesë me pretendimin se në emision por edhe në profilin e tij në rrjetet sociale dhe video materialit të transmetuar në emisionin Pressing, bëhen fabrikime të informacionit, ndjellje të urrejtjes, denigrim të personalitetit të tij dhe plasohen informacioneve të rrejshme (të pabaza, pa evidencë dhe pa fakte në asnjë rast). KPM me qëllim të shqyrtimit të ankesës ka bërë monitorimin e emisionit dhe ka gjetur se TE7 nuk ka bërë shkelje të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03. Palës ankuese i është kthyer përgjigje. Rasti është mbyllur.

DEPARTAMENTI I MENAXHIMIT FREKUENCOR

Analiza e Spektrit Frekuencor –Transmetimet analoge

Gjatë vitit 2020, janë bërë matje dhe monitoruar radio televizionet nacionale, radio televizionet regjionale e lokale në terren në tërë territorin e Kosovës, për të incizuar gjendjen e transmetimeve radio televizive tokësore në brezat frekuencor (radio FM VHF/III dhe TV VHF/III; TV UHF/IV/V) me qëllim të vlerësimit, analizimit, respektivisht konstatimit të:

- Gjendjes për transmetimet radio televizive tokësore analoge me mbulim nacional të subjekteve të licencuara, gjegjësisht evidentimin e zonave të pambuluara me sinjal radioteleviziv.
- Gjendjes për transmetimet radio televizive tokësore analoge me mbulim regjional/lokal të subjekteve të licencuara.
- Evidentimit të interferencave në brezin frekuencor radiodifuziv dhe evidentimit të frekuencave të lira të mundshme për radio transmetime në territorin e Kosovës.

- Gjendjes për prezencën e sinjaleve radio televizive tokësore dixhitale, gjegjësisht evidentimit të prezencës së sinjaleve nga shtetet fqinjë.
- Gjithashtu, janë monitoruar edhe frekuencat radio që i shfrytëzojnë KFOR-i, UNMIK-u dhe radio stacionet e huaja ndërkombëtare për nevojat e tyre.
- Janë monitoruar radio televizionet nacionale, radio televizionet regjionale e lokale me qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së zonës së mbulimit me pjesën e dytë dhe të katërt të Licencës.

Mbulueshmëria me sinjal televiziv në nivel nacional (RTK, KTV, RTV21)

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra, wshtw vërtetuar se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV të subjekteve transmetuese nacionale është e një kualiteti shumë të mirë (65 dBuV/m për TV) dhe e pa interferuar për ato lokacione që i mbulojnë, dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë e të katërt të licencës. Megjithatë, duhet të theksohet se nga raportet e mëhershme, mbulimi i tërësishëm i territorit të Kosovës nuk është i kënaqshëm. Aktualisht, territori i Republikës së Kosovës mbulohet vetëm 62,7% me sinjal televiziv. Regjione të tëra si: Dragashi, Kaçaniku, Zhupa, Kamenica, Klina, Artana, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi kanë mbetur në tërësi apo pjesërisht jashtë zonës së mbulimit me sinjal televiziv për shkak të problemit të vazhdueshëm të mos aktivizimit të pikës së lartë të Goleshit, për transmetim primar televiziv si dhe mos aktivizimit të rrjetit sekondar (rrjeti i përsëritësve televiziv). Në këtë kontekst, KPM-ja në vazhdimësi ka informuar organet më të larta shtetërore të Republikës së Kosovës, për rëndësinë e aktivizimit të kësaj pike për transmetim televiziv.

Pika e lartë e Goleshit përdoret vetëm nga KFOR-i për transmetime radio FM. Për të siguruar mbulueshmëri më të gjerë me sinjal televiziv është shumë e rëndësishme që kjo pikë të aktivizohet edhe për subjektet transmetuese televizive.

Maja e Goleshit është e regjistruar në ITU, respektivisht në të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare që nga Stokholm 61, Gjeneva 84, 89 dhe e fundit Gjeneva 2006, si pikë kryesore e transmetimit për Kosovën. Për këtë arsye janë të rezervuara dhe të pranura ndërkombëtarisht kanale transmetimi radio e televizive me fuqi të mëdha rrezatimi. Me aktivizimin e kësaj pike të lartë të Goleshit për transmetim televiziv, do të rritej zona e mbulimit nga 62.7% (me nivel të sinjalit të kënaqshëm prej 60 dBuV/m) në 80% të territorit të Kosovës dhe do të mundësohej zhvillimi i rrjetit sekondar, ashtu që arrihet që mbi 90% e territorit të Kosovës të mbulohet me sinjal televiziv kualitativ.

Të dhënat nga kontrollet dhe matjet dëshmojnë se shfrytëzimi i spektrit frekuencor në territorin e Kosovës vazhdon të mbetet përafërsisht i njëjtë në krahasim me situatën në vitin 2019, me përjashtim të numrit të madh të sinjaleve radio dhe TV që vijnë nga vendet fqinje (Serbia, Maqedonia dhe Shqipëria).

Mbulueshmëria me sinjal Radio FM në nivel nacional (Radio Kosova 1, Radio Kosova 2, Radio 21 dhe Radio Dukagjini)

Gjatë vitit 2020, Departamenti për Menaxhim Frekuencor (DMF) ka bërë matjet në kuadër të përcaktimit të objektivave të KPM-së për vitin 2020, të cilat kanë pasur për qëllim sigurimin e mbulueshmërisë së zonave të veçanta gjeografike të territorit të Republikës së Kosovës (me theks të veçantë rrugët magjistrale dhe regjionale), me sinjal kualitativ të të licencuarve me mbulim nacional në radio, në brezin frekuencor VHF/FM (87.5 - 108 MHz).

DMF-ja gjatë matjeve të bëra në terren ka vërtetuar gjendjen e njëjtë si gjatë vitit paraprak që tregon se, në disa zona të caktuara, Radio Kosova 1, Radio Kosova 2 dhe Radio 21 nuk ofrojnë mbulim të mirë, ndërsa niveli i sinjalit të mbulueshmërisë është nën nivelin e duhur të 54 dBuV/m për këto zona. Matjet teknike janë bërë në disa rrugë magjistrale si: Prishtinë-Gjilan (Slivovë, Llabjan, Parilovë dhe Bresalc); Kaçanik–Hani i Elezit; Mitrovicë–Bajgorë; Shtime–Carrallevë, Dragash–Restelicë; Prizren–Brezovicë; Kramovik–Dollc; Pejë–Rugovë; Kamenicë, dhe është vërejtur se në këto zona nuk ka pranim (i dobët, nën 46dBuV/m mono) të sinjalit të radiove nacionale.

Në bazë të këtyre rezultateve, KPM rekomandon se Radio Kosova 1, Radio Kosova 2 dhe Radio 21 nuk janë duke transmetuar në pajtim me statusin e radiove nacionale duke mos arritur të mbulojnë tërë popullatën e Kosovës, ndërsa Radio Dukagjini në koordinim me KPM-në është duke bërë zgjerimin e zonës së mbulimit në tërë territorin e Kosovës.

KPM është e gatshme që të sigurojë frekuenca shtesë me qëllim të mbulimit të zonave ku nuk ka fare sinjal, ndërsa në bashkëpunim me ta të gjejmë lokacionet e përshtatshme për pika të transmetimit.

Mbulimi me sinjal televiziv në nivel regjional dhe lokal

Nga matjet në terren dhe analizat e bëra është vërtetuar se gjendja e mbulueshmërisë me sinjale TV dhe radio të subjekteve transmetuese është e një kualiteti shumë të mirë (60 dBuV/m për TV dhe 54 dBuV/m për FM Stereo radio transmetime) dhe e pa interferuar për ato lokacione që i mbulojnë dhe se zona e shërbimit është në pajtueshmëri me pjesën e dytë dhe të katërt të licencës.

Televizionet lokale/regjionale mbulojnë rreth 68.14% të territorit të Kosovës me sinjal televiziv ndërsa, radiot lokale/regjionale mbulojnë rreth 96.98% të territorit të Kosovës (të gjitha së bashku).

Rastet për interferencë

Gjatë vitit 2020, DMF nuk ka pranuar ankesa për interferencë nga subjektet transmetuese, radio dhe TV, që vërteton se spektri frekuencor (TV dhe radio) është i sinkronizuar dhe i pa interferuar.

Rastet për transmetime të pa licencuara

DMF gjatë vitit 2020 nuk ka hasur në pranim të ndonjë sinjali FM TV i cili është i pa licencuar nga ana e KPM-së.

Frekuencat e revokuara nga KPM

DMF gjatë vitit 2020 nuk ka proceduar me asnjë rast për të cilën është dashur të revokohet ndonjë frekuencë (licencë).

Monitorime të radio frekuencave ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me KFOR

DMF gjatë vitit 2020 ka bërë edhe monitorime të frekuencave radio që janë në shfrytëzim të KFOR-it, UNMIK-ut dhe radiostacioneve të huaja ndërkombëtare me qëllim të azhurnimit të bazës së të dhënave që posedon KPM-ja.

Gjatë vitit 2020, radiot e huaja ndërkombëtare si BBC, VOA dhe RFI vazhdojnë transmetimet e tyre.

Frekuencat për transmetime radio FM që i përdor KFOR-i, UNMIK-u dhe radiostacionet e huaja ndërkombëtare, nuk i janë nënshtruar procesit të licencimit afatgjatë, dhe si të tilla mund të paraqesin interferencë në të ardhmen për shkak të mos instalimit të filtrave dalës.

Gjithashtu, ka vazhduar bashkëpunimi i KPM-së me KFOR-in për të siguruar pikën e lartë të Goleshit si zonë transmetuese e lirë dhe opsionet për të arritur këtë mbesin të trajtohen përmes Marrëveshjeve të Mirëkuptimit në mes institucioneve relevante kosovare dhe KFOR-it.

Gjatë vitit 2020, KPM ka pasur një bashkëpunim shumë të mirë me KFOR-in sa i përket aspektit të frekuencave FM, ku si rezultat KFOR ka shprehur të pajiset me licencë për frekuencat FM radio të cilat i shfrytëzon për radio KFOR.

Kërkesa për ndryshim të lokacionit të transmetimit

Gjatë vitit 2020, DMF ka pranuar kërkesë për ndryshim të lokacionit nga Radio K në Junik, ku pas analizave kjo kërkesë është aprovuar nga Komisioni.

Raste të ndryshimit të lokacionit të transmetuesit pa miratim të KPM-së

Gjatë vitit 2020, DMF nuk ka proceduar me ndonjë rast të subjekteve transmetuese të cilat kanë bërë ndryshimin e pikës së transmetimit pa miratimin e KPM-së.

A. Subjektet transmetuese të cilat kanë ndërprerë transmetimin tokësor, ose kanë zvogëluar zonën e mbulueshmërisë:

Gjatë vitit 2020, një numër shumë i madh i TV-ve me mbulim regjional kanë pasur ndërprerje të transmetimit tokësor. TV Besa, TV Opinioni, TV Prizreni, TV Festina, TV Liria, TV Iliria dhe TV Mitrovica nga matjet në terren është konstatuar se mbi 90% të matjeve kanë rezultuar se nuk kanë

qenë në transmetim tokësor. Ndërsa me probleme më të vogla në transmetim tokësor janë TV Herc, TV Most dhe TV Mir.

Po ashtu, matje janë bërë edhe për sinjalin FM radio ku është konstatuar se: Radio Bubamara, Radio Hayat, Radio Kent FM (Mamushë), Radio Bambus, Radio Klllokoti, Radio Bravo, Radio Borzani, Radio Herc, Radio Helix, Radio Dardania dhe Radio Kaçaniku nuk janë duke respektuar licencën e KPM-së, pra nuk janë në transmetim tokësor.

B. Kërkesë për frekuencë shtesë dhe frekuenca të reja:

Gjatë vitit 2020, nuk ka pasur kërkesa nga Komisioni i KPM-së për shpalljen e frekuencave të lira. KPM ka pranuar kërkesë për frekuenca shtesë vetëm nga Radio Dukagjini, ndërsa nga radiot tjera nacionale nuk ka pasur kërkesa të tilla.

DMF ka bërë matje në tërë territorin e Republikës së Kosovës lidhur me gjetjen dhe përditësimin e frekuencave të lira Radio FM dhe TV.

C. Plani frekuencor dhe dixhitalizimi

Gjatë vitit 2020, DMF ka bërë përditësimin e planit të frekuencave për transmetim tokësor televiziv dixhital në Republikën e Kosovës, si obligim nga Ligji Nr. 05/L-027 për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore. DMF ka bërë matje në terren lidhur me verifikimin e kanaleve të cilat janë ndarë nga ITU për transmetim dixhital në territorin e Republikës së Kosovës. Nga këto matje është konstatuar se këto kanale nuk janë të interferuara nga vendet fqinje.

Gjendja për prezencën e sinjaleve televizive tokësore dixhitale, gjegjësisht evidentimi i prezencës së sinjaleve nga shtetet fqinje

Nga matjet në terren, janë regjistruar një numër i caktuar i sinjaleve televizive dixhitale që vijnë nga territori i vendeve fqinje (Serbia dhe Maqedonia), e ngjashme me vitin 2019.

Matjet e bëra kanë përfshirë tërë territorin e Kosovës, me theks të veçantë pikat nacionale të transmetimeve radio televizive tokësore analoge si dhe lokacionet pranë kufirit me shtetet fqinje.

Rekomandime

Udhëzohen radiot me mbulim Nacional RTK, Radio 21 të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme që të ngritin kualitetin e sinjalit VUSH/FM nëpër rrugët magjistrale – rajonale të Kosovës, duke transmetuar me fuqitë (ERP) të parapara sipas licencave të KPM-së nëpër pikat transmetuese nacionale në frekuencat gjegjëse, ndërsa radio Dukagjinit të vazhdojë në përmirësim të mbulimit nëpër rrugët magjistrale dhe rajonale, ndërsa KPM do të ofroj frekuenca të lira radio për nevojat e RTK, Radio 21 dhe radio Dukagjinit në shfrytëzim të mbulimit plotësues të kësaj pjesë të rrugës magjistrale, si dhe të pjesëve të tjera rrugore të Kosovës.

DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS DHE FINANCAVE

Buxheti

Buxheti për Komisionin e Pavarur të Mediave për vitin 2020, është i bazuar në Ligjin me Nr.07/L-001 dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me nr. 07/L-001 të rishikuar, mbi Ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Buxheti i rishikuar për KPM për vitin 2020 në krahasim me Ligjin mbi Buxhetin për vitin 2020 ka pësuar ndryshime në kategoritë ekonomike: Paga dhe Rroga, Mallra dhe shërbime dhe Shpenzime komunale.

Ndryshimet e Buxhetit fillestar ndaj Buxhetit final janë aprovuar: Në mbështetje të Ligjit 07/L-014 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit me nr. 07/L-001; Vendim të Qeverisë me nr. 01/46; Vendim të Qeverisë me nr.09/50 dhe me Vendim të Qeverisë me nr.50.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2020, Buxheti fillestar në vlerë prej 951,794.99 € në krahasim me Buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 775,212.36 €.

Nga totali i Buxhetit final në vlerë prej 775,212.36 € është shpenzuar shuma në vlerë prej: 726,517.58 € dhe Buxheti i pa shpenzuar ka qenë në vlerë prej 48,694.78 € apo 93.72 %.

Buxheti final është zvogëluar për 176,582.63 € ose 18.55 % në krahasim me Buxhetin fillestar (951,794.99 €).

Buxheti i rishikuar për KPM-në për vitin 2020 në krahasim me Ligjin mbi Buxhetin ka pësuar ndryshime në kategoritë ekonomike:

Paga dhe Rroga është zvogëluar për 112,751.97 €; Mallrave dhe shërbimeve është më e ulët për 54,357.50 € dhe Shërbimeve komunale është zvogëluar për 9,473.16 €.

Buxheti i Komisionit të Pavarur i Mediave për vitin 2020				
Kategoritë	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	Buxheti i shpenzuar	Buxheti i pashpenzuar
Pagat dhe Rogat	446,681.99	333,930.02	333,930.02	0.00
Mallra dhe Shërbime	347,113.00	292,755.50	244,458.56	48,296.94
Shërbime Komunale	28,000.00	18,526.84	18,409.00	117.84
Projekti Kapital				

Moderniz.infrastr. IT-së	120,000.00	120,000.00	119,950.00	50.00
Programi i të Hyrave	10,000.00	10,000.00	9,770.00	230.00
Total:	951,794.99	775,212.36	726,517.58	48,694.78

Në kategorinë e Pagave dhe rrogave, Buxheti fillestar në vlerë prej 446.681.99 € në krahasim me Buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 333,930.02 € dhe janë shpenzuar mjete në vlerë prej 333,930.02 € apo 100.00 %.

Në kategorinë e Mallrave dhe shërbimeve, Buxheti fillestar në vlerë prej 347,113.00 € në krahasim me Buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 292,755.50 € dhe është shpenzuar shuma në vlerë prej 244,458.56 €, ndërsa Buxheti i pashpenzuar ka qenë në vlerë prej 48,296.94 € apo 83.50%.

Në kategorinë e Shërbimeve komunale, Buxheti fillestar në vlerë prej 28,000.00 € në krahasim me Buxhetin final është zvogëluar në vlerë prej 18,526.84 € dhe është shpenzuar shuma në vlerë prej 18,409.00 €, ndërsa Buxheti i pashpenzuar ka qenë në vlerë prej 117.84 € apo 99.36%.

Në kategorinë e Projekteve Kapitale janë ndarë dy Projekte në vlerë prej 130,000.00 €:

1. “Modernizimi i Infrastrukturës së IT-së” - Projekti i Aprovuar në vlerë prej 120,000.00 € është shpenzuar shuma në vlerë prej 119,950.00 € dhe Buxheti i pashpenzuar është në vlerë prej 50.00 € apo 99.96 %; dhe

2. “Softueri për të Hyrat e KPM-së” - Projekti i Aprovuar në vlerë prej 10,000.00 € është shpenzuar shuma në vlerë prej 9,770.00 € dhe Buxheti i pashpenzuar është në vlerë prej 230.00 € apo 97.70 %. Projektet Kapitale burimin e fondeve e kanë nga Granti Qeveritar.

Realizimi i të hyrave

Duke u bazuar në Rregulloren për Nivelin dhe Mënyrën e Pagesës së Tarifës për Licencë KPM-2017/06, të Licencuarit e KPM-së obligohen të paguajnë tarifën për licencë në baza vjetore për secilin vit fiskal. Afati për pagesën e tarifave vjetore të të licencuarve të KPM-së është 30 qershori i vitit respektiv.

KPM prej tarifës së licencës për vitin 2020 ka planifikuar që të realizoj të hyra në vlerë prej 263,770.00 €.

Nga të hyrat e mbledhura prej Komisionit të Pavarur të Mediave, janë gjeneruar 286,522.15 €, prej tyre 269,225.05 € u takojnë të hyrave nga tarifa për licencë, ndërsa shuma prej 17,089.20 € u takojnë të hyrave nga gjobot dhe shuma prej 207.90 € u takojnë të hyrave nga dënimet për media (kamatë).

Në kuadër të Realizimit të të Hyrave është përfshirë vlera e të hyrave të mbledhura për vitin 2020 me vlerë prej 220,938.78 € dhe të hyrat e realizuara të viteve paraprake janë në vlerë prej 65,583.37 €. Këto të Hyra përmes llogarisë së KPM-së kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Gjatë periudhës raportuese kemi një rritje prej 68,171.45 € apo 23.79 % më tepër krahasuar me të hyrat e realizuara në periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Të arkëtueshmet nga tarifa për licencë

Obligimet nga tarifa për licencë dhe gjobat të cilat kanë statusin e të arkëtueshmeve në vlerë prej 682,260.81 €, janë si pasojë e mos pagesave të obligimeve për pagesën e tarifës së licencës, kamatës dhe gjobave. Shuma totale në vlerë prej 507,852.18 € janë obligime financiare nga tarifa për licencë dhe 23,080.37 € nga kamatat. Ndërsa, shuma në vlerë prej 151,328.26 € janë obligime nga gjobat.

Të gjitha obligimet për mos pagesën e tarifës vjetore për licencë nga viti 2011-2013 janë proceduar për ekzekutim në Gjykatën Themelore dhe për vitet 2014-2020 janë proceduar te përmbaruesi privat.

Në kuadër të Ll/A në vlerë prej 682,260.81 € është e përfshirë vlera e Ll/A të krijuara në vitin 2020 me vlerë prej: 57,180.66 € dhe Ll/A të viteve paraprake 625,080.15 €.

Vlera e llogarive të arkëtueshme (LL/A) në vlerë prej 682,260.81 €, në krahasim me vitin paraprak është zvogëluar për 5,613.47 € (687,874.28 € në vitin 2019) apo 0.82 %.

Në Shtojcën IIIa është dhënë Raporti buxhetor i detajuar, i cili paraqitet edhe në Ministrinë e Financave dhe në Zyrën Kombëtare të Auditimit (Shtojca II Raporti Vjetor Financiar 2020).

PUNA E BORDIT PËR ANKESA

Bordi për Ankesa (BA) është organ i pavarur në bazë të nenit 36 të Ligjit për KPM-në. Bordi i Ankesave shqyrton ankesat e palëve që drejtpërdrejt kanë të bëjnë me Vendimet e Komisionit të KPM-së. Bordi për Ankesa përbëhet prej tre (3) anëtarëve të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Nga radhët e anëtarëve të Bordit për Ankesa, Kuvendi zgjedh Kryetarin. Anëtarët e Bordit për Ankesa emërohen me mandat tre (3) vjeçar.

Përbërja aktuale e Bordit për Ankesa

Bordi për Ankesa i KPM-së, që nga 16 qershori i vitit 2019 dhe deri më 29 tetor 2020 ka qenë i përberë nga vetëm një (1) anëtar, nga tre (3) sa duhet t'i ketë, pra nuk qenë në përbërje të plotë dhe as funksional. Kuvendi i Republikës së Kosovës, në seancën e mbajtur më 29 tetor 2020, ka emëruar për anëtar të Bordit për Ankesa z. Ylber Fetahaj me mandat tre (3) vjeçar dhe z. Avdyl Hyseni anëtar të Bordit për Ankesa me mandat tre (3) vjeçar, ashtu siç parashihet me nenin 40, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 04/L-44 për KPM-në. Mirëpo, nuk e ka zgjedhur Kryetarin e Bordit, deri me Vendimin e datës 29 dhjetor 2020, kur e ka zgjedhur z. Ylber Fetahaj si Kryetar të Bordit për Ankesa.

Përbërja e Bordit gjatë vitit 2020

Emri	Mbiemri	Pozita	i/e emëruar	Kohëzgjatja e mandatit
Ylber	FETAHAJ	Kryetar	29 tetor 2020	mandat tre (3) vjeçar
Avdyl	HYSENI	Anëtar	29 tetor 2020	mandat tre (3) vjeçar
Ilaz	RUDAKU	Anëtar	15 mars 2018	mandat tre (3) vjeçar

Seancat dhe Vendimet e Bordit për Ankesa

Bordi për Ankesa (BA) gjatë vitit 2020 nuk ka mbajtur asnjë seancë shqyrtuese, për arsye se nuk ka pasur kuorum për trajtimin e ankesave ndaj Vendimeve të Komisionit të KPM-së.

OBJEKTIVAT E PËRCAKTUARA PËR VITIN 2020

Gjatë vitit 2020 kanë qenë të planifikuara objektivat e mëposhtme, por për shkak të situatës me pandeminë Covid-19, nuk është arritur të realizohen shumë prej objektivave, e të cilat barten për vitin 2021.

1. Avancimi i kornizës ligjore

- Amandamenti i Rregullores për Shpërndarjes e Ofruesve të Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuele;
- Amandamenti i Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuele;
- Amandamenti i Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale;
- Amandamenti i Rregullores për Përcaktimin e Tarifës për Licencë të KPM-së;
- Miratimi i Rregullores për Pronësinë dhe Koncentrimin e Mediave;

2. Promovimi i Edukimit Medial “Media Literacy”

- Krijimi i një platforme ndërinstytucionale për promovim dhe zhvillim të edukimit medial, duke definuar qartë rolin e KPM-së në këtë platformë;

3. Dixhitalizimi i shërbimeve të KPM-së (e-KPM)

- Faturimi elektronik;
- Databasa për futjen e të dhënave të aktiviteteve brenda KPM-së;
- Qasja e publikut në mënyrë elektronike;

4. Implementimi i dixhitalizimit në nivel shtetëror

- Inicimi i ndërtimit të rrjetit për transmetim dixhital në nivel shtetëror;
- Licencimi i MUX-ave në pajtim me Ligjin për Transmetim Dixhital;

OBJEKTIVAT E VITIT 2021

Gjatë vitit 2021, KPM-ja synon t’i arrijë objektivat e parapara si në vijim:

1. Avancimi i kornizës ligjore

- Miratimi i Rregullores për Pronësinë dhe Koncentrimin e Mediave;
- Amandamenti i Rregullores për Përcaktimin e Tarifës për Licencë të KPM-së;
- Amandamenti i Rregullores për Dhënien e Licencës;
- Amandamenti i Rregullores për Komunikime Komerciale Audiovizuele;
- Amandamenti i Rregullores për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të Miturve në Shërbimet Mediale;

2. Promovimi i Edukimit Medial “Media Literacy”

- Krijimi i një platforme ndërinstytucionale për promovim dhe zhvillim të edukimit medial, duke definuar qartë rolin e KPM-së në këtë platformë;

3. Dixhitalizimi i shërbimeve të KPM-së (e-KPM)

- Faturimi elektronik;
- Databaza për futjen e të dhënave të aktiviteteve brenda KPM-së;
- Qasja e publikut në mënyrë elektronike

4. Implementimi i dixhitalizimit në nivel shtetëror

- Inicimi i ndërtimit të rrjetit për transmetim dixhital në nivel shtetëror;
- Licencimi i MUX-ave në pajtim me Ligjin për Transmetim Dixhital;

5. Zgjerimi i rrjetit të bashkëpunimit me organizatat vendore dhe ndërkombëtare

REKOMANDIMET/SFIDAT E INSTITUCIONIT

Vështirësitë dhe sfidat lidhur me pavarësinë financiare

Shkurtime buxhetore nga Ministria e Financave pa komunikim me KPM-në dhe pa ndonjë analizë, po pamundësojnë funksionimin e KPM-së si një institucion i pavarur dhe po rrezikon përmbushjen e objektivave të parapara për vitet e ardhshme. Gjithashtu, sfidë mbetet edhe mos lejimi i shfrytëzimit të të hyrave nga tarifat vjetore të licencave siç përcaktohet me Ligjin për KPM-në, e që është element shtesë që garanton pavarësinë e institucionit.

Nevoja për rritjen e numrit të stafit

Në vazhdimësi, KPM-ja ka parashtruar kërkesa për shtimin e numrit të stafit, duke u bazuar në kërkesat reale që ndërlidhen me zgjerimin e fushëveprimit të KPM-së, marrë parasysh edhe faktin se numri i të licencuarve nga KPM-ja është rritur dukshëm, përfshirë edhe paraqitjen e platformave të reja mediale si rezultat i zhvillimeve teknologjike, duke shtuar volumnin e detyrave për nëpunësit ekzistues.

Aktualisht, KPM-ja është duke u ballafaquar me mungesë të theksuar të stafit dhe si rezultat i kësaj në vazhdimësi ka ngarkesa në punë, të cilat po rezultojnë edhe me pamundësinë e kryerjes së detyrave sipas pritjeve. Kjo gjendje gjithsesi mund të ketë edhe efekte negative sa i përket zbatimit të rregulloreve dhe procedurave në punë. Mungesa e stafit do të vështirësoj edhe punën e KPM-së në zbatimin e Ligjit për KPM-në dhe atij për Dixhitalizimin e Transmetimeve Radiodifuzive Tokësore.

AUDITIMI I PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2019

Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)

Nga vlerësimet e ZKA për implementimin e rekomandimeve të ZKA për vitin 2018 dhe 2019, janë zbatuar të gjitha rekomandimet.

Po ashtu, edhe nga vlerësimet e AB i MF për vitin 2019 janë zbatuar të gjitha rekomandimet.

Sipas opinionit të auditimit, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Gjatë Auditimit nuk është dhënë asnjë rekomandim.

Zyra Kombëtare e Auditimit për vitin 2019 ka vlerësuar dhe ka dhënë opinion të pamodifikuar.